# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7634 E martë 28 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)










Opinioni i Ditës

Nga MUJË BUÇPAPAJ

### Referendumi për emrin në Maqedoni dhe ndikimi i tij në rajon



Tërheqja e Maqedonisë nga lufta e ftohtë me Greqinë për çështjen e emrit, i ka hapur tashmë rrugë referendumit të 30 shtatorit 2018, për të legalizuar ...

Vijon në faqen 18



Dje në "Zërin e Amerikës"

Nga JOHN MCCAIN

### Letër lamtumire

Senatori John McCain, i cili vdiq të shtunën në moshën 81-vjeçare nga kanceri në tru, ka lënë një letër lamtumire për bashkëkombësit e tij. "Jetova dhe ...

Vijon në faqen 19



Shkodër/ Shpallet në kërkim Fredi Pllumi

## Vritet 54-vjeçari me thikë në zemër, para dy ditësh e denoncoi autorin për vjedhje

Prendush Fushaj e akuzoi 30-vjeçarin se i grabiti paratë. U shoqërua dhe u la i lirë

SENAD NIKSHIQI

Një vrasje me thikë ka ndodhur në orët e pasdites së djeshme në Shkodër. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në vendin e quajtur "Ura e Thive" në lagjen "Mark Lula". Viktima është 54-vjeçari Prendush Fushaj. Ky shtetas ka ...

Në faqen 6

LISTA E PLOTE/ STUDENTET E RINJ NE UNIVERSITETIN E TIRANES

# ARSIMI I LARTE, SHPALLEN FITUESIT NE 3 FAKULTETE

Kush do të vazhdojë studimet tek degët e psikologjisë, filozofisë, shkencave politike, informatikës, juridikut. Si do të bëhet regjistrimi



*(Në foto) Studentë*

Në faqet 8-11

"BISEDIME ME ITALINE"

### Bushati: Pranimi i emigrantëve, jo për integrimin në Bashkimin Europian

Në faqen 4

NGA DASHNOR KALOÇI

### Motra e Bardhok Bibës: Refuzova të firmos që jam e dalë mendsh, me burgosën

Në faqet 20-21

STUDIMI: 13% E POPULLSISE

### Shqipëria vendos rekord, 367 mijë vetë aplikuan për Lotarinë Amerikane

Në faqen 7

TRAGJEDIA NE ROSKOVEC





### Aksidenti me 2 të vdekur, i plagosuri: Makina na përplasi me 130 km në orë

Në faqen 5

Komisioneri i Zgjerimit të BE, Johanes Hahn: Të ruhet stabiliteti në Ballkan

## Thaçi-Vuçiç: Korrigjim kufijve të Kosovës

*Rama mbledh në Durrës kryeministrat e rajonit: Rrisim bashkëpunimin*

Në Alpbach të Austrisë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai serb, Aleksandër Vuçiç kërkuan mbështetje nga të gjithë për një marrëveshje finale Kosovë-Serbi, që mund të derivojë edhe me "korrigjim territori". Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë Aleksandër Vuçiç, folën hapur rreth mundësisë së korrigjimit të kufirit, por të dy në mënyrë të kujdesshme e shprehën këtë ide, a dashur të shkaktojnë shqetësime në opinion për ndonjë tensionim të mundshëm në ...



Në faqet 2-3

"SUMMER PAGES"

### Rajmonda Balilaj: Pengu më i madh, koha ndaj familjes. Politika, pasion

Suplement

DIPLOMACIA
REAGIMET

Presidenti i Kosovës dhe Serbisë flasin për "korrigjim të mundshëm territori"

# Kufijtë, Thaçi: Për marrëveshjen finale kemi nevojë për BE e SHBA

## "Askush të mos ketë frikë nga 'korrigjim kufiri'"

Në Alpbach të Austrisë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai serb, Aleksandër Vuçiç kërkuan mbështetje nga të gjithë për një marrëveshje finale Kosovë-Serbi, që mund të derivojë edhe me "korrigjim territori". Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë Aleksandër Vuçiç, folën hapur rreth mundësisë së korrigjimit të kufirit, por të dy në mënyrë të kujdesshme e shprehën këtë ide, pa dashur të shkaktojnë shqetësime në opinion për ndonjë tension të mundshëm në Ballkan.

**STABILITETI**

Aleksandër Vuçiç dhe Hashim Thaçi, morën pjesë në forumin e Alpbach-ut në Austri, ku të pranishëm ishin edhe presidenti i Austrisë, Aleksander Van der Bellen ai i Sllovenisë, Borut Pahor dhe Komisioneri i BE-së për zgjerim Johanes Hahn. Madje edhe ky i fundit tha se çfarëdo marrëveshje që del nga të dyja palët, ajo duhet përkrahur. "Pa marrë parasysh se cila është zgjidhja dhe ne nuk përjashtojmë asgjë, duhet ta dimë se gjëja më e rëndësishme është stabiliteti në rajon. Kjo lloj marrëveshje nuk duhet të shtyjë ide të tjera në rajon",- tha Johanes Hahn.

**"KUFIRI"**

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në përfundim të forumit tha në një konferencë të përbashkët për media se "Prishtina dhe Beogradi kanë nevojë për ndihmën e të gjithëve, Bashkimit Europian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës për ta arritur një marrëveshje finale. "Presim marrëveshjen për kufirin, ngase, nëse nuk e arrijmë këtë, e rrezikojmë të ardhmen europiane. Andaj, kemi vendosur të eksplorojmë shumë mënyra dhe jemi të gatshëm të arrijmë deri te marrëveshja",-tha presidenti Thaçi, duke shtuar se "askush nuk duhet të ketë frikë nga një marrëveshje e mundshme mes Kosovës dhe Serbisë edhe nëse kjo marrëveshje do të thotë korrigjim kufiri". Sipas tij, "Kosova dhe Serbia nuk do të jenë as të parat, as të fundit që bëjnë korrigjim kufiri".



Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë Aleksander Vuçiç dje në Austri

**TAKIMI**
Presidenti Hashim Thaçi dhe Aleksandër Vuçiç do të takohen me Bruksel më 7 shtator në zyrën e shefes së diplomacisë evropiane Federica Mogherini. Edhe Thaçi edhe Vuçiç, thanë se takimi pritet të jetë i vështirë, ndërsa, nuk e konfirmuan nëse në këtë takim do të hapet zyrtarisht "tema e korrigjimit të territorit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë".



Foto zyrtare e pjesëmarrësve në samitin e kryeministrave rajonal dje në Durrës

**ALEKSANDER VUÇIÇ**
Zgjidhja do të jetë e dhimbshme për të dyja vendet, por kjo do të thotë që në të dyja anët do të ketë sadopak kënaqësi, gjithashtu", tha Vuçiç.

**MARRËVESHJA**

Sipas Presidentit të Kosovës, "pa arritjen e një marrëveshjeje, Kosova dhe Serbia do ta bllokojnë njëra-tjetrën në rrugën drejt BE-së dhe rajoni do të vuajë nga rreziku i jostabilitetit". Ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, nga ana e tij, thotë se shqiptarët dhe serbët si dy popujt më të mëdhenj në rajon, duhet të arrijnë një marrëveshje historike. "Ne duhet t'i zgjidhim problemet tona me shqiptarët, për hir të serbëve për hir të shqiptarëve dhe për hir të gjithë rajonit. Sepse serbët e shqiptarët janë bindshëm popujt më të mëdhenj në rajon",-tha Aleksandër Vuçiç, duke shtuar se megjithatë, "njohja e pavarësisë së Kosovës nga Serbia, pa fituar asgjë në këmbim, nuk ka gjasa të ndodhë".

**PROBLEMI**

"Nuk jam i sigurt se njerëzit në Serbi do të mbështesin ndonjë marrëveshje, por ne do të bëjmë më të mirën për të zgjidhur problemin qindravjeçar. Premtimi për njerëzit e mi është se do të investojmë të gjitha përpjekjet për të gjetur një zgjidhje finale për problemin me shqiptarët. Zgjidhja do të jetë e dhimbshme për të dyja vendet, por kjo do të thotë që në të dyja anët do të ketë sadopak kënaqësi, gjithashtu", tha Vuçiç. Sipas tij, konflikti i ngrirë me shqiptarët nuk duhet të vazhdojë, sepse në fund "dikush dikur do ta shkrijë dhe më pas do të kemi luftë". Presidenti i Austrisë, Alexander Van der Bellen, i cili ishte nikoqir i takimit, të Forumit Evropian në Alpbach, tha se "procesi i integrimit dhe zgjerimit të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të vazhdojë", ndërsa duke ju referuar dialogut Kosovë-Serbi, ai tha se "Kosova dhe Serbia duhet të arrijnë një marrëveshje historike. "Dialogu mbetet esencial në rrugën e Kosovës dhe Serbisë për integrim. Jam i bindur se të dy presidentët Thaçi dhe Vuçiç janë të përkushtuar në arritjen në një marrëveshje historike",-tha Presidenti i Austrisë, Van der Bellen.

**Tre kryeministrat e rajonit mungojnë në samit**

## Berisha: 4 nga 7 kryeministra munguan, s'deshën t'u ngjiten pleshta

Ish-kryeministri Sali Berisha e quajti të dështuar takimin e djeshëm të kryeministrave të vendeve të rajonit në Durrës. Në një postim në rrjetet sociale e quan këtë "me pak se gjysmë takimi". Sipas tij arsyeja është mungesa e kuorumit pasi nga 7 kryeministri të Ballkanit Perëndimor, ishin vetëm 3, ndër ta 2 shqiptarë. Berisha shprehet se ata munguan se nuk deshën t'u ngjitën pleshta në narkoshtetin e Noriegës. "Me pak se gjysmë takimi! "Takimet multilaterale janë të dobishme, por kur nga 7 kryeministra të ftuar 4 nuk "gjejnë" dot kohe për të ardhur, janë pa kuorum dhe me shume se dështim. Kjo veçanërisht kur nga 3 të pranishëm 2 janë shqiptarë. Le t'i themi faleminderit kryeministrit të Malit të Zi se përndryshe do kishim një takim thjesht ndërshqiptar. Natyrisht ky bojkot ka vetëm një shkak: munguan se nuk deshën t'u ngjiten pleshta në narkoshtetin e Noriegës, i vetëm në Europë dhe në botë!",-shkruan Berisha në 'Facebook'. Kryeministri Rama Rama tha se në takim është diskutuar mbi marrëdhëniet për ecurinë e përbashkët në BE të rajonit teksa tregoi arsyet e mungesës së kryeministrave. "Kushtet objektive kanë pamundësuar praninë e disa miqve të tjerë, i shpreh ngushëllimet tona kryeministrit bullgar Borisov për aksidentin tragjik ku humbën jetën shumë persona dhe është bërë shkak për anulimin në minutën e fundit të ardhjes së tij, po ashtu kryeministri i Maqedonisë e ka pasur të pamundur fluturimin për shkak të kohës, kryeministrja e Serbisë na përcolli keqardhjen. Duke bërë një bilanc të ecurisë të procesit të krijimit të zonës ekonomike. Kemi diskutuar më gjerësisht për marrëdhëniet për ecurinë e përbashkët në BE. Objektiv ngritja e qendrës për zhvillimin e qëndrueshëm teknologjik në Malin e Zi, iniciativë që e mbështesim fuqimisht"- tha Rama.



REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Dossier:** Iv Kaloçi, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli,
***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI. ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Komisioneri: Në BE asnjë anëtar pa zgjidhur marrëdhëniet dypalëshe

# Ndryshimi i kufijve, Hahn: Të ruhet stabiliteti në rajon

## *Rama: Firmos për çka tha komisioneri*

Valentina Madani

Komisioneri për Zgjerim Johannes Hahn edhe pse i rezervuar dje gjithsesi u përfshi në debatin e hapur për korrigjimin e kufijve të Kosovës dhe Serbisë. Komisioneri për Zgjerim deklaroi se çdo lloj marrëveshje dypalëshe duhet të ketë si objektiv kyç që të gjenerojë stabilitet në rajon dhe jo të kundërtën. Sipas tij qëndrimi i BE është i qartë, asnjë kandidat për në këtë familje nuk mund të bëhet pjesë e saj nëse më parë nuk ka zgjidhur mosmarrëveshjet për kufijtë me fqinjët. "Nuk jam i gatshëm të bëj asnjë koment përveç atij që është parashkruar në strategjinë e zgjerimit: nuk do të pranojmë asnjë anëtar të ri nëse nuk janë të zgjidhura marrëdhëniet dypalëshe. Ajo që ka vlerë për ne është stabiliteti në të gjithë rajonin. Duhet të mbajmë parasysh që çdo lloj marrëveshje dypalëshe nuk duhet të rrezikojë stabilitetin e përgjithshëm të rajonit, por duhet të jetë krejt e kundërta, duhet të kontribuojë për më shumë stabilitet në rajon. Dhe cilido që të jetë objektivi përfundimtar ky duhet të jetë objektivi kyç. Sa më shumë stabilitet në të gjithë rajonin duke zgjidhur mirëfilli konfliktet dypalëshe",- u shpreh z.Hahn. Kryeministri Rama, i cili ende nuk ka bërë një koment për këtë çështje, zgjodhi sërish ta shmangë përgjigjen, por duke deklaruar se qëndrimi i komisionerit ka mbështetjen e tij. "Firmos për çka tha komisioneri". Komisioneri Hahn mirëpret takimin e dy presidentëve Thaçi dhe Vuçiç në 7 shtator, por është i bindur se nuk do të jetë takimi i fundit mes tyre dhe se kjo çështje do të marrë kohë deri sa të gjejë zgjidhje përfundimtare.

**SAMITI**

Kryeministri Edi Rama në konferencën për shtyp pas samitit informal me liderët e Ballkanit në Durrës, bëri thirrje për më shumë bashkëpunim ekonomik mes vendeve të rajonit. Ai tha se është e domosdoshme të shfrytëzohet territori i përbashkët në mënyrë që të gjitha vendet të dalin të fituara. "Përveç progresit brenda vendit, është e domosdoshme të shfrytëzojmë territorin e përbashkët të rajonit tonë përmes bashkëpunimit. Është pikërisht të qenit pjesë e BE me shumë pak barriera seç kemi ne, është faktor ndryshues i ekonomisë së atyre vendeve që janë", tha z.Rama. Gjatë fjalës së tij, komisioneri Johannes Hahn përgëzoi vendet e Ballkanit për punën e deritanishme si dhe shprehu mendimin se rajoni ka një potencial të pashfrytëzuar. "Jam i impresionuar nga fakti që në Shqipëri, bota e mediave dominohet nga zonjat. Mendoj që miratimi përfundimtar nga viti që vjen të mund të bëhet realitet. Kemi dhënë një dritë jeshile për sa i përket liberalizimit të vizave për Kosovën, dhe shpresojmë ta realizojmë sa më shpejt. Ajo që kemi realizuar deri tani është mbresëlënëse. Pas shumë vitesh tregtia ndërmjet rajonit është rritur shumë, me 18%. Numri i vendeve të punës është krijuar si pasojë e rritjes ekonomike të vendeve të rajonit. Kjo tregon potencialin e rajonit që pret të shfrytëzohet. Mund të ekzistojë mundësia që dy vendet e mbetura për marrëveshjen e romingut, të bëhet dhe ky është hap i rëndësishëm. Rajoni ka potencial të pashfrytëzuar"- tha Hahn.



**INTEGRIMI**

Në Durrës u zhvillua samiti informal një ditor mes udhëheqësve të vendeve të Ballkanit Perëndimor me temë "Integrimi i Ekonomisë Rajonale". Në fokus të samitit është rritja e zbatimit të angazhimeve të marra në Samitin e Triestes në korrik 2017, që synon të sigurojë mundësi të reja për bizneset dhe për qytetarët, si dhe do të forcojë zhvillimin dhe vendet e punës.

"S'ka nevojë për kreativitet, t'i respektojmë kufijtë"

## Takimi i kryeministrave të rajonit, Haradinaj: Kufijtë nuk lëvizin!

Ramush Haradinaj e gjeti me vend dje në Durrës të ripërsëriste qëndrimin e tij, të ndryshëm me atë të Presidentit Thaçi që e ka hedhur për diskutim publik propozimin për korrigjimin e kufijve. Kryeministri i Kosovës, deklaroi se duhen respektuar kufijtë aktual që i ka Kosova me vendet fqinje. Haradinaj foli në konferencën për shtyp në samitin informal të liderëve të Ballkanit Perëndimor, ku përmendi edhe vështirësitë që ka shteti i Kosovës në mungesë të lirisë së lëvizjes. Shefi i ekzekutivit theksoi problemet e qytetarëve të Kosovës të cilat vijnë si pasojë e mos-liberalizimit të vizave. Gjithashtu, Haradinaj foli për takimin e dy qeverive që pritet të mbahet në muajin nëntor në Pejë, mes Kosovës



dhe Shqipërisë, ku tha se do të finalizohen procedurat e mbetura për heqje të burokracive doganore. "Ne kemi ende vështirësi në qarkullim të lirë, kur kalojmë nëpër Serbi qytetarët tanë presin me orë të tëra qoftë në kthim qoftë në shkuarje, pastaj kemi vështirësi në qarkullim ose nuk mund të shkojmë në Bosnje, për të komunikuar me Kroacinë na duhen viza, është vend i BE-së, e bën jetën tonë më të vështirë ekonomike. Ajo që e kemi më lehtë, dhe besoj që do ta avancojmë në nivelin e duhur, është marrëdhënia jonë, dy ekonomitë Kosovë-Shqipëri. Ashtu siç kemi rënë dakord me ju, Edi, në gjysmën e dytë në nëntorit do të kemi takimin e përbashkët të dy qeverive në Pejë dhe besoj do t'i finalizojmë të gjitha procedurat e mbetura për heqje të burokracive doganore, të cilat i vonojnë edhe qytetarët, por edhe ekonominë dhe sipërmarrësit. Kosova i ka kufijtë e vet, me Shqipërinë, me Malin e Zi, me Maqedoninë, me Serbinë, ne respektojmë këta kufij dhe nuk mendojmë se duhet ndonjë kreativitet i ri në dizajnim të tyre, por duhet t'i respektojmë kufijtë që i kemi",-tha z.Haradinaj.



**SHKURT**

### Koçijançiç: Kosovës dhe Serbisë t'u jepet hapësirë për marrëveshje

Komisioni Europian vlerëson se Kosovës dhe Serbisë duhet t'iu jepet hapësirë që të merren vesh për përmbajtjen e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve,-tha zëdhënësja e Komisionit, Maja Koçijançiç. Në një konferencë për gazetarët në Bruksel, Koçijançiç tha se BE-ja, si ndërmjetësuese e dialogut, nuk mund t'i komentojë elementet e mundshme të marrëveshjes, porse do të vazhdojë të punojë në mënyrë intensive me të dyja palët për arritjen e një ujdie gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, e cila do të mbështetet nga bashkësia ndërkombëtare. Koçijançiç theksoi se "zgjidhja e përhershme nënkupton zgjidhje të qëndrueshme dhe reale, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare". E pyetur nga gazetarët nëse BE pranon ndryshimin e kufijve, shkëmbim të territoreve dhe territore të pastra etnike, Koçijançiç tha se nuk dëshiron të futet në spekulime dhe detaje "në këtë fazë të fundit të dialogut".



### Topalli për kufijtë: Kryeministri lau duart si Pilati

Ish-kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli reagoi dje ashpër për qëndrimin e kryeministrit Edi Rama në lidhje me korrigjimin e kufijve të Kosovës. Topalli shprehet se kryeministri lau duart si Pilati kur tha se mendonte si Hahn, ndërsa për heshtjen epike të kryetarit të opozitës në Shqipëri, sipas Topallit, nuk duhet t'ia vini re pasi ai nuk ekziston. "Për çështjen e kufijve-kryeministri lau duart si Pilati, kryetari i opozitës nuk ekziston. Prej disa javësh Presidenti Thaçi dhe Vuçiç flasin për ndryshime kufijsh. Ditët e fundit, dueti ka hyrë në procesin e shkëmbimeve të territoreve… As sot në takimin informal të kryeministrave( të munguar) të rajonit nuk u fol për atë që po ndodh, me përjashtim të Haradinajt. Thua se kufijtë janë çështje e dorës së fundit. Ku e ku me pak e rëndësishme se roaming në rajon që nuk i hyn kujt fort në punë. Kosova i ka kufijtë e saj tha natyrshëm kryeministri i Kosovës edhe ne konferencë shtypi",- tha zj.Topalli.



**REFUGJATET**
**VENDIMI**

Ministri tregon arsyen e marrjes së refugjatëve: Ka pasur njerëz që na kanë kritikuar

# Pranimi i emigrantëve, Bushati: Nuk e shfrytëzojmë për integrimin në BE

## *"Për vendimin patëm diskutime të gjata"*



Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati për emisionin 'Newshour' në BBC, komentoi vendimin e qeverisë shqiptare për të marrë 20 emigrantët nga Eritrea, të cilët ndodhen në brigjet italiane. Ministri Bushati sqaron se: "Shqipëria për asnjë moment nuk e sheh krizën e refugjatëve si mënyrë për të përparuar me procesin e integrimit në BE. Procesi ynë - vijon ai, bazohet në rregulla dhe parime të tjera. Duke iu referuar rastit, Bushati sqaron se kemi të bëjmë me jetë njerëzish, qofshin këto eritreas apo europiane. Kjo është një krizë masive dhe asnjë vend europian nuk e përballon dot vetëm".

**Z. ministër, pse pranoi Shqipëria të marrë disa nga emigrantët nga Eritrea? Nuk është anëtare e BE-së, por aspiron të bëhet e tillë.**

Është një vendim që e kemi bërë tashmë publik, pas diskutimeve të gjata me autoritetet italiane, të cilat na kërkuan mbështetje në këto përpjekje. Gjithashtu, përputhet me qëndrimin e Shqipërisë katër vite më parë, kur nisi kriza e refugjatëve, sipas të cilit të gjitha vendet e Europës, pavarësisht nëse janë pjesë e BE-së apo jo, duhet të kontribuojnë disi në tejkalimin e krizës, sepse kriza e emigrimit është një krizë evropiane, ndaj kërkon përgjigje europiane.

**Kuptova, gjithashtu, se kjo që po ndodh sot ju kujton atë që ka ndodhur me shqiptarët më shumë se 20 vite më parë.**

Është e vërtetë. Kur regjimi komunist ishte duke rënë, shumë shqiptarë u larguan nga vendi, për shkak të arsyeve politike, por kryesisht ekonomike. Nuk duhet ta harrojmë historinë tonë të 2-3 dekadave më parë. Ky ishte një tjetër faktor motivues.

**Dhe kjo histori përfshinte Italinë që pranoi shqiptarët që donin të largoheshin nga vendi.**

Po, Italia po na shpëtonte. Shumë shqiptarë u pranuan prej saj gjatë atyre kohëve dramatike. Tani është radha jonë që të kontribuojmë në këtë proces. E di shumë mirë, sepse ka pasur njerëz që na kanë kritikuar. Na kanë thënë që refugjatët që po ndihmojmë nuk janë nga Italia, por nga Eritrea. Por këtu po flasim për njerëz, në radhë të parë. Ndonjëherë harrojmë që janë qenie njerëzore, dhe së dyti, kjo është një krizë masive. Asnjë vend europian nuk e përballon dot vetëm.

**A po i dërgoni kështu një mesazh edhe disa vendeve të Europës së Veriut, të cilat kanë qenë më pak mikpritëse?**

Fatkeqësisht, e kemi parë Europën të përçarë. Kemi parë vende jo vetëm në veri të Europës, por edhe në lindje, të cilat e kanë harruar historinë e tyre. Unë mund të kujtoj çastet e rënies së Murit të Berlinit, por edhe gjatë komunizmit ka pasur shumë njerëz nga ana lindore që i largoheshin komunizmit dhe shkonin në perëndim. Mendoj se është një mesazh edhe për BE-në, që na duhet një pikëpamje më koherente, një përgjigje më koherente për çështje kaq të rëndësishme. Edhe nga perspektiva e vendeve kandidate, siç është Shqipëria.

**Shpresoni që kjo t'i bëjë vendet e BE-së ta shohin kandidaturën tuaj me sy më pozitiv?**

Nuk e shohim krizën e refugjatëve si mënyrë për të përparuar me procesin e integrimit në BE. Procesi ynë bazohet në rregulla dhe parime të tjera. Sigurisht që do të donim ta shihnim BE-në më të angazhuar me çështjet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë vendin tim. Kemi dëgjuar në të shkuarën debate për ndërtimin e kampeve të refugjatëve jashtë BE-së. Kjo do të ishte e papranueshme, sepse ne e shohim këtë si një përpjekje të përbashkët me vende të tjera të BE-së.

**TRITAN SHEHU**

Pranimi e 20 emigrantëve të bllokuar në Katania të Italisë, deputeti i PD-së Tritan Shehu e quan qesharake dhe reklamë nga ana e Ramës, duke ditur që një gjë të tillë ligji nuk e lejon.



**EDI PALOKA**

Nënkryetari i PD-së Edi Paloka deklaroi se 20 afrikanët nuk janë ndërruar me hapjen e negociatave, por është pazar për foton e kryeministrit Rama me futbollistin e Juventus Kristiano Ronaldo.

### Kryeministri: Vendimi s'është tregti me BE-në

## 'Emigrantët', Rama: S'mund të rrinim spektatorë përballë një shfaqjeje të turpshme



Kryeministri Edi Rama foli dje për herë të parë pas vendimit për të pranuar 20 nga 150 emigrantët nga Lindja e Mesme dhe Afrika, të cilët ishin bllokuar prej disa ditësh në brigjet italiane në pritje të zbarkimit. Në një intervistë për "Corriere Della Sera", Rama shprehet se vendimi nuk është tregti me BE-në për çështjen e emigrimit, por se të gjithë duhet të bëjmë pjesën e tyre. Po dje në përfundim të takimit informal në Durrës mes kryeministrave të Ballkanit, kryeministri Rama u pyet për marrjen e 20 emigrantëve nga Eritrea, dhe në përgjigjen e tij tha se nuk ka asgjë të fshehtë, por është vetëm një gjest human. "Nuk e kemi bërë këtë për këdo qoftë. Ne e kemi bërë këtë për të mos ndenjur spektator në një shfaqe dhimbje dhe turpi. Nuk mund të shikonim njerëz që kishin ardhur nga ferri, qëndronin të burgosur nga impotenca e politikës, rajonale pse jo dhe europiane. Ne bëmë aq sa mundëm, është rasti për të kujtuar se Ballkani në krizën e 2015, bëri atë që duhet të bënte e gjithë Europa. Vendi ynë nuk ka asnjë qëllim të fshehtë, por është në botën mediatike për të rrëmuar në gjëra të fshehta",-tha z.Rama.



## Presidenti i Puglias: Rama shpëtoi qeverinë tonë, Shqipëria sa më parë në BE!

Presidenti i rajonit të Puglias, Michele Emiliano, përmes një statusi në 'Facebook' foli për çështjen e pranimit të 20 refugjatëve nga Shqipëria. Emiliano shkruan se kryeministri shqiptar Edi Rama shpëtoi qeverinë italiane, dhe se vendi ynë i dha një mesazh gjithë botës, sepse Shqipëria duhet të hyjë sa më parë në BE. Qeveria jonë u shpëtua nga Edi Rama dhe Papa Francesco. Shqipëria i dha një leksion gjithë botës. Miku im Edi Rama, kryeministri i Shqipërisë iu shpjegoi të gjithëve pse Shqipëria duhet të hyjë sa më parë në Bashkimin Europian. Duke bërë këtë, e shpëtoi qeverinë italiane nga një situatë e sikletshme dhe katastrofike, e shkaktuar nga mungesa e eksperiencës dhe injorancës juridike", deklaroi presidenti i rajonit të Puglias.

U përplasën për vdekje teksa ecnin në trotuar, kush janë dy viktimat

# Aksidenti në Roskovec, flet i plagosuri: Dëgjuam një zhurmë frenimi, makina më përplasi në mur

## Martin Dogani: E njoh shoferin, ishte me shpejtësi

Ina Allkanjari

**FIER**

Pas aksidentit të rëndë të ndodhur mbrëmjen e së dielës në fshatin Arapaj të Roskovecit, ku humbën jetën dy kushërinjtë Amarildo Dogani dhe Festim Dogani, flet i vetmi i mbijetuar, Martin Dogani. 22-vjeçari fatmirësisht ndodhet jashtë rrezikut për jetën dhe mësohet se ka marrë vetëm disa plagë nga aksidenti. I tronditur nga përplasja dhe fundit fatal që patën dy çunat e xhajës së Martinit, i riu tregon se si rrodhi ngjarja. "Ne ishim 3 çuna xhaxhallarësh, rreth gjysmë metra nga trotuari jo në asfalt. Kishim pirë kafe dhe dolëm jashtë dhe po rrinim. Në muhabet e sipër dëgjojmë një zhurmë frenimi të madhe. Mua më kapi cepi i makinës dhe më përplasi në mur. Më pas unë ngela pa ndjenja. Dy çunat e xhaxhallarëve i përplasi për matanë", u shpreh Martin Dogani. Sipas uniformave blu u bë më dije se të rinjtë u aksidentuan nga një mjet që drejtohej nga shtetasi Amarildo Çalamani. Mësohet se makina tip "Volkswagen" e drejtuar nga 21-vjeçari ka qenë me shpejtësi dhe pasi ka hipur në trotuarin e këmbësorëve ku përplasi tre të rinjtë, ka përfunduar në një kanal. Çalamani është larguar pas aksidentit, por është arrestuar pak minuta më vonë nga policia. Ndërkohë i mbijetuari Martin Dogani tregon nga spitali se e njeh shoferin pasi është banor i zonës, në fshatin Arapaj të Roskovecit.

"Amarildo Çalamani është banorë i zonës. E kam pasur shok shkolle.

Ai ishte me shpejtësi, besoj me 130km në orë. Ka bërë frenim dhe në atë moment nuk e ka mbledhur. Rruga ku ndodhi aksidenti ka qenë skëterrë, por faji është i personave që nuk janë në rregull, sepse duhet të ecin me avash dhe nuk duhet të ecin me shpejtësi. Nuk është faji i rrugës",-tregoi 22-vjeçari Martin Dogani. Ndërsa një e afërme e djemve, konkretisht zonja e shtëpisë ku u përplas makina, Fatmira Dogani, e cila ishte dëshmitare e ngjarjes së rëndë, tregon tmerrin që pa nga aksidenti që i mori jetën dy të rinjve. "Erdhi makina me shpejtësi, isha në oborr, pashë që 2 i vërviti i mori zvarrë, një e përplasi në mur. Ç'të shihja, u mblodh gjithë fshati, i futën në makina për t'i çuar në spital, po ç't'i çoje. Jemi të shokuar e të trembur, kanë ndodhur dy ngjarje njëra pas tjetrës. Në fund të muajit djali i xhaxhait me dy fëmijët, sa morën veten ata, mbrëmë tragjedia tjetër. Dy të vdekur një i plagosur. Mora të plagosurin në prehër, zhurmë e madhe. Kemi frikë të çojmë fëmijët në shkollë, kemi frikë të dalim në dyqan se më kanë ndodhur 2 herë përpara shtëpisë. Që kur është bërë rruga, kalojnë shumë shpejt këtu",-tha Fatmira Dogani. Ndërkohë banorët e fshatit Arapaj thonë se aksidentet në këtë rrugë janë të përsëritura. Ata shprehen se rruga edhe pse e ndërtuar rishtazi, është jashtë çdo kriteri, pa sinjalistikën e duhur. "Ka një muaj që është bërë rruga dhe kanë ndodhur 3 aksidente. Rreth dy km qendër e banuar, pa sinjalistikë, pa barriera mbrojtëse pa çdo gjë",-shprehet një banor i zonës.

**NGJARJA**

Një aksident i rëndë i mori jetën dy kushërinjve Dogani mbrëmjen e së dielës në fshatin Arapaj të Roskovecit, ndërsa mbeti i plagosur një i tretë. Viktimat janë Amarildo Dogani 29 vjeç dhe Festim Dogani 21 vjeç, kushërinj me njëritjetrin. Ndërsa i plagosur ka mbetur Martin Dogani 22 vjeç, i cili ndodhet në spital. Ata ishin duke ecur në anë të rrugës kur janë përplasur nga një makinë tip "Volkswagen" e drejtuar nga Amarildo Çalamani. Dyshohet se drejtuesi i mjetit që ka përplasur tre personat ka qenë me shpejtësi dhe ka perfunduar në kanal. Ai është larguar pas aksidentit, por është arrestuar pak minuta më vonë nga policia. Në këtë aks rrugor mungon ndriçimi dhe sinjalistika e duhur. "Në datën 26.08.2018, në orën 20:40, në urgjencën e Spitalit Fier janë sjellë në gjendje të rëndë shëndetësore e më pas kanë ndërruar jetë shtetasit A.D, 29 vjeç dhe F.D, 21 vjeç, të dy banues në fshatin Arapaj, Roskovec. Nga të dhënat paraprake, të dy shtetasit janë aksidentuar në fshatin Arapaj, nga një mjet që drejtohej nga shtetasi Amarildo Çalamani banues në fshatin Arapaj. Shërbimet e policisë bën të mundur kapjen e tij dhe e shoqëruan në Komisariatin e Policisë Fier për të kryer veprime të mëtejshme dhe zbardhjen e plotë të ngjarjes. Dy viktimat kanë qenë këmbësorë ndërsa mjeti ka dalë nga rruga dhe ka rënë në kanal",-thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkohë grupi hetimor po punon për sqarimin e plotë të rrethanave të këtij aksidenti.





Viktimat Amarildo Dogani dhe Festim Dogani

## Kush është Amarildo Çalameni, 21-vjeçari që aksidentoi për vdekje dy kushërinjtë



Autori Amarildo Çalameni

**ROSKOVEC**- Amarildo Çalameni me origjinë nga fshati Arapaj, personi, i cili aksidentoi për vdekje dy kushërinjtë Dogani mbrëmjen e së dielës, rezulton të jetë shofer problematik. Mësohet se 21-vjeçari është gjobitur disa herë për shkelje të ndryshme administrative. Ai është ndëshkuar 10 herë me gjobë, konkretisht: brenda vitit 2018 ka marrë 3 masa për parakalime të gabuara, 2 masa për përdorim celulari, 1 masë administrative për tejkalim shpejtësie me pezullim të lejes së drejtimit në vitin 2017, dhe një masë për mungesë kontrolli teknik. Pezullimi i lejes se drejtimit dhe gjobat e herëpashershme ndaj 21-vjeçarit Amarildo Çalamani për tejkalim shpejtësie dhe përdorim celulari mesa duket nuk kanë rezultuar të dobishme. E fundit shkelje e tij, pati pasoja fatale për 2 të rinj.

SHKURT

### Fier, përplasen dy makina, një fëmijë i plagosur

**Fier-** Në qytetin e Fierit është regjistruar një tjetër aksident automobilistik ditën e djeshme, por fatmirësisht këtë herë pa viktima.
Mësohet se një dy automjete janë përplasur në urën e Mbrostarit ku i lënduar lehtë ka mbetur një fëmijë, ndërsa dëmet e tjera kanë qenë materiale. Si pasojë e aksidentit është bllokuar qarkullimi për disa minuta ç'ka ka sjellë një trafik të rënduar në këtë aks.

### Aksident në aksin Përrenjas-Qafë Thanë, plagosen 5 gra dhe 2 fëmijë

**ELBASAN**- Një aksident ka ndodhur pasditen e djeshme në aksin Përrenjas- Qafë Thanë. Dy automjete, një me targa të Tiranës dhe një tjetër me targa të Maqedonisë janë përplasur në këtë aks, e për pasojë kanë mbetur të plagosur 7 persona, mes tyre 5 gra dhe 2 fëmijë, 3 prej grave shtetase të Maqedonisë. Të plagosurit janë dërguar menjëherë në spitalin e Librazhdit. Policia ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe ka nisur hetimet për zbardhjen e rrethanave, ndërsa dyshohet se aksidenti ka ndodhur gjatë një parakalimit të gabuar.


*United Nations Development Programme*

**VACANCY ANNOUNCEMENT**

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following consultancy vacancy.

| | |
|---|---|
| ***Job ID:*** | *18140* |
| ***Post Title:*** | *Public Relat & Comm Assistant* |
| ***Duty station:*** | *Tirana, Albania* |
| **Duration of Assignment:** | 1 year with possibility of extension |
| **Type of Contract:** | Service Contract (SC) |
| **Educational Background:** | G-Bachelor's Level Degree – 5 year(s) experience |
| **Work Experience:** | At least 5 years, of progressively responsible experience in PR and media relations; Proven skills to draft communications strategies on behalf of international, national organizations and or private sector. Must possess a solid understanding of local governance issues· Ability to work in a pressured environment with strict deadlines; |
| **Deadline for Application:** | **10/09/2018 (Midnight New York, USA)** |
| **Job Description:** | Available at UNDP site: https://jobs.partneragencies.net/erecruitjobs.html?JobOpeningId=18140&hrs_jo_pst_seq=1&hrs_site_id=2 |

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.

### Sekuestrohen 11 kg kanabis dhe 40 doza

## Policia bën bilancin: Tri operacione antidrogë brenda 24 orëve, 5 të arrestuar



Në 24 orët e fundit janë realizuar tre operacione antidrogë ku janë sekuestruar një sasi prej 11.2 kg kanabisi si dhe 40 doza. Sipas policisë së shtetit në kuadër të këtyre operacioneve arrestuan 5 persona. Në Tiranë, shërbimet e "Forcave Shigjeta" gjatë kontrolleve të zhvilluara në kryeqytet arrestuan 2 persona si dhe sekuestruan 40 doza kanabisi. Në rrugën "Pandi Dardha", "Shigjetat" në bashkëpunim me apecialistët për Hetimin e Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, prangosën M.B., 15 vjeç, pasi gjatë kontrollit në trup iu gjetën 32 doza kanabisi. Ndërkohë pas kontrollit të një automjeti të tipit 'Skoda' në rrugën "Lord Bajron", shërbimet e "Forcës Shigjeta" zbuluan 8 doza kanabisi si dhe arrestuan drejtuesin e automjetit Erin Koçiaj 21 vjeç. Policia nisi procedim në gjendje të lirë edhe për E.B., 22 vjeç me akuzën e "Moskallëzimit të krimit", i cili ishte pasagjer në automjetin tip 'Skoda'. Në fshatin Cakran në Fier, pas një informacioni të marrë në rrugë operative efektivët e rendit arrestuan 27-vjeçarin Durim Korçari. Pas kontrollit në banesën e tij, policia zbuloi një sasi prej 5 kilogramë kanabisi. Droga ishte e ndarë në 5 pako të mbështjella me letër alumini në formë drejtkëndore. Sipas hetimeve të policisë lënda narkotike dyshohet se po përgatitej të trafikohej në shtetin fqinj, Greqi. Ndërkohë policia e Kukësit goditi një tjetër rast të trafikut të lëndëve narkotike. Gjatë operacionit të koduar "WEKEND", pas kontrollit të një automjeti tip 'Volkswagen' në vendin e quajtur "Kepi i Rinisë", në fshatin Ujmisht, agjentët zbuluan një sasi prej 6.2 kilogramë kanabisi. Policia arrestoi drejtuesin e mjetit Izmir Haxhia, 38 vjeç dhe Eduart Matmujën, 35 vjeç. Nga hetimet rezultonte se 35-vjeçari Matmuja ishte porositësi i lëndës narkotike e cila do të trafikohej në Kosovë, ndërsa Haxhia kishte rolin e transportuesit. Gjatë operacionit policia sekuestroi automjetin me të cilin transportohej lënda narkotike, 2 telefona celularë si dhe 150 euro. Agjentët e antidrogës po vijojnë punën për identifikimin e personave të tjerë të implikuar në këtë trafik.

### Policia e la të lirë, 30-vjeçari sulmon Prendush Fushajn në afërsi të banesës

# Akuzoi fqinjin për vjedhje, vritet me thikë 54-vjeçari në Shkodër

## *Shpallet në kërkim autori i dyshuar, Fredi Pllumi*

Senad Nikshiqi

Një vrasje me thikë ka ndodhur në orët e pasdites së djeshme në Shkodër. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në vendin e quajtur "Ura e Thive" në lagjen "Mark Lula". Viktima është 54-vjeçari Prendush Fushaj. Ky shtetas ka marrë një goditje poshtë zemrës me thikë duke bërë që të mos arrijë ta përballojë dhe të humbasë jetën. Fushaj është sulmuar në afërsi të banesës së tij. Menjëherë në vendngjarje ka mbërritur një ambulancë e spitalit rajonal të Shkodrës duke bërë të mundur transportimin e 54-vjeçarit në urgjencën e spitalit. Në pak minuta mjekët kanë konfirmuar ndarjen nga jeta të Prendush Fushaj duke qenë se goditjen me thikë e ka marrë në zemër dhe ka humbur sasi të konsiderueshme gjaku. Forcat e policisë menjëherë pas informacioneve të marra në rrugë operative në terren kanë arritur të bëjnë të mundur identifikimin e autorit të dyshuar. Sipas efektivëve është 30-vjeçari Fredi Pllumi. Burimet policore bëjnë me dije se ditët e fundit në banesën e viktimës është vjedhur një shumë e konsiderueshme parash. Pas kësaj ngjarje viktima Prendush Fushaj ka shkuar në policinë vendore të Shkodrës dhe ka bërë një padi duke përmendur si autor të vjedhjes pikërisht 30-vjeçarin Fredi Pllumi dhe disa persona të tjerë. Forcat e policisë kanë shoqëruar në ambientet e policisë shtetasin që 54-vjeçari e ka përmendur si autor të vjedhjes, por Fredi Pllumi ka deklaruar për oficerët se ai nuk është autori i vjedhjes dhe se nuk ka asnjë lidhje me atë ngjarje të ndodhur në banesën e Prendush Fushaj. Policia duke mos patur prova për autorësinë e vjedhjes e ka lënë të lirë 30-vjeçarin, pavarësisht akuzave të ngritura ndaj tij për vjedhje. Më pas Fredi Pllumi gjatë pasdites së djeshme ka shkuar në banesën e Prendush Fushaj duke i kërkuar llogari në lidhje me padinë për vjedhje që ka bërë në adresë të tij. 30-vjeçari ia ka mohuar se është ai autor i vjedhjes, por nga ana tjetër Fushaj nuk është bindur nga fjalët e tij. Biseda ka agravuar më shumë mes tyre duke debatuara lidhur me ngjarjen. Të dy shtetasit e përfshirë në këtë debat kanë ngritur tonet aq sa i kanë dëgjuar edhe persona të tjerë që kanë qëlluar në afërsi. Në debat e sipër policia dyshon se shtetasi Fredi Pllumi ka nxjerrë një thikë që e kishte me vete dhe ka goditur poshtë zemrës 54-vjeçarin Prendush Fushaj, i cili mbeti i plagosur rëndë dhe më pas humbi jetën në spitalin rajonal të Shkodrës. Policia është vënë në ndjekje të autorit të dyshuar teksa po punohet për gjetjen dhe më pas kapjen e tij.



Viktima Prendush Fushaj

**VIKTIMA**
Viktima është 54-vjeçari Prendush Fushaj. Ky shtetas ka marrë një goditje poshtë zemrës me thikë duke bërë që të mos arrijë ta përballojë dhe të humbasë jetën. Fushaj është sulmuar në afërsi të banesës së tij. Menjëherë në vendngjarje ka mbërritur një ambulancë e spitalit rajonal të Shkodrës duke bërë të mundur transportimin e 54-vjeçarit në urgjencën e spitalit.

### Raporti, në 2016 u hetuan 0.51% e dosjeve

## Shqipëria në vend të fundit në Ballkan për hetimin e çështjeve të korrupsionit

Shqipëria përgjatë kësaj dekade ka pasur numrin më të ulët të çështjeve të hetuara për korrupsion në raport me vendet e tjera të Ballkanit sipas një krahasimi që ka bërë Këshilli i Koordinimit Rajonal (RCC). Sipas të dhënave shihet se, Shqipëria hetoi për korrupsion vetëm 0.51 % të çështjeve të hetuara gjithsej gjatë vitit 2016, teksa në vendet e tjera të Rajonit, numri i çështjeve të hetuara ishte shumë me i lartë, deklaron Monitor. Në Bosnje në vitin 2016 rreth 14 për qind e investigimeve të prokurorisë ishte për çështjet e korrupsionit. Në Malin e Zi, gjithashtu, rastet e korrupsionit zunë 10.5 për qind të çështjeve të hetuara dhe në Serbi 9.97 për qind. Madje edhe Kosova kishte çështje të hetuara për korrupsion gati sa dyfishi i Shqipërisë, ku rreth 1.1 % e hetimeve i dedikoheshin rasteve të korrupsionit. Lufta kundër korrupsionit është një nder kushtet kryesore të vendit për integrimin në BE. Teksa studime dhe indekse të ndryshme e nxjerrin Shqipërinë si një nder vendet me të korruptuara në Rajon. Një studim i ekonomistëve të BERZH, Peter Sanfey dhe Jakov Milatovic, të cilët kanë dhënë një diagnozë për ekonominë në rajonin e Ballkanit kanë gjetur se, pengesat e biznesit imponojnë kosto të mëdha për ndërmarrjet dhe funksionojnë si taksa të fshehura në aktivitetet e tyre. Sipas tyre, mesatarisht, firmat në Ballkan humbasin 13.2% të shitjeve të tyre vjetore për shkak të katër pengesave në mjedisin e biznesit, përkatësisht krimit, mungesës së energjisë elektrike dhe infrastrukturës së dobët. Shqipëria e ka këtë tregues 15% dhe humbjet më të larta sipas grafikut të mëposhtëm i ka prania e krimit. Rrugët jo të mira dhe pagesat korruptive, gjithashtu, janë kosto për bizneset në Shqipëri. Për pasojë, produktiviteti i firmave në Ballkan është dukshëm më poshtë standardeve të BE-së, duke reflektuar institucionet e dobëta dhe një mjedis të vështirë biznesi, konstatojnë ekonomistët.




**Shitje me Ankand te dyte nga Studio Permbarimore L.D.C**

"Truall + ndertese", me nr pasurie 31/12, ZK 3428, vol 5, fq 3 me siperfaqe totale trualli 1.837 m2 dhe siperfaqe ndertese 260.6 m2 me adrese fshati Shtoj i Ri, Shkoder. Regjistruar ne Z.V.R.P.P Shkoder ne emer te Zako Spaso Ajkoviq . Çmimi fillestar per shitje eshte 15.680.000 Leke.
Data e shpalljes **26.07.2018**
Data e zhvillimit **30.08.2018 deri ne oren 16.00**
Ankandi zhvillohet ne ambjentet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

Pasuria nr. 3/438+2-53, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 36, FAQE 37, SIPËRFAQE 103 M2, ZONA KADASTRALE 8380, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ALBAN QEMAL BALA.
**ÇMIMI 8.700.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 24.09.2018**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

“Pew Research Center”: Shqipëria mban rekord, e para në Europë për aplikimet

# “Mbi 367 mijë shqiptarë aplikuan për Lotarinë Amerikane në 2018”

Plot 367,231 shqiptarë aplikuan për lotarinë amerikane gjatë këtij viti, duke u renditur kështu në vendin e parë në Europë për sa i përket numrit të kërkesave për tokën e premtuar. Sipas statistikave të publikuara nga “Pew Research Center”, në Shqipëri kanë aplikuar 13% e popullsisë, ndërsa vendet e lindjes janë ato që kryesojnë. Sipas të dhënave të Departamentit Amerikan të Shtetit, në vitin 2017, kanë aplikuar për lotarinë plot 315,842, ndërsa në vitin 2018, ky numër është rritur më tej, duke shkuar në 367,231 aplikues. Në Europë, pas Shqipërisë vjen Moldavia me 11% si dhe Armenia me 9 për qind. Në Azi, Uzbekistani dhe Nepali renditen të parët, përkatësisht me 7 dhe 4%,



ndërsa në Afrikë renditet Sierra Leone me 14% dhe Gana me 9%.

Sipas raportit në përgjithësi pothuajse 1% e njerëzve në vendet përkatëse kërkuan programin e lotarisë, ndërsa në total kanë aplikuar 22.4 milionë njerëz në vitin 2017 për programin e vizave. SHBA-të kanë pranuar vetëm 50 mijë persona, që u jepet karta jeshile, duke ju mundësuar vendbanim të përhershëm atje. Megjithatë, numri i aplikuesve në vitin 2017 pësoi ulje, pasi një vit më herët kishin aplikuar 23 milionë persona. Ulja erdhi pasi administrata e Trump dhe disa anëtarë të Kongresit kanë kërkuar të eliminojnë programin - i vetmi i këtij lloji në nivel global. Programi ka nisur në vitin 1995, dhe aplikuesit janë pranuar çdo vit, zakonisht në vjeshtë. Përfituesit e vizave përzgjidhen rastësisht dhe mund të hyjnë në SHBA afërsisht dy vjet pas aplikimit të tyre fillestar. Për shembull, fituesit e lotarisë që aplikuan në vitin kalendarik 2017 kanë kohë deri më 30 shtator 2019, për të marrë vizën e diversitetit. Megjithatë, jo të gjithë banorët e shteteve të botës mund të aplikojnë. Për shembull, banorët e Meksikës, Kinës dhe Indisë nuk mund të aplikojnë për shkak të numrit të madh të emigrantëve që kanë dërguar në SHBA, zakonisht numri i kalon 50 mijë. Lista e vendeve të kualifikuara mund të ndryshojë çdo vit. Për shembull, për shkak të rritjes së emigracionit në SHBA, qytetarët e Bangladeshit u bënë të papërshtatshëm për lotarinë duke filluar nga viti 2011 dhe ata nga Nigeria u bënë të papërshtatshëm që nga viti 2013.

## Kompleks i ri sportiv në Petrelë Veliaj: Nxitje për të lënë llotot

| 10 | 181706600103 | 974.87 |
| 11 | 180912400034 | 972.25 |
| 12 | 182922400081 | 972.11 |
| 13 | 180708000235 | 972.09 |
| 14 | 181939700182 | 970.6 |
| 15 | 181807300004 | 970.07 |
| 16 | 181937900412 | 968.92 |
| 17 | 181114000069 | 968.5 |
| 18 | 181939800007 | 968.22 |
| 19 | 181939700249 | 967.33 |
| 20 | 181114000035 | 966.98 |
| 21 | 183123900030 | 966.87 |
| 22 | 181958300001 | 965.98 |
| 23 | 183341300013 | 965.39 |
| 24 | 181807200239 | 965.04 |
| 25 | 183341300232 | 964.22 |
| 26 | 181939400214 | 963.89 |
| 27 | 181417600018 | 963.56 |
| 28 | 182922400052 | 963.4 |
| 29 | 181705200218 | 963.3 |
| 30 | 183825800006 | 963.06 |
| 31 | 182526300153 | 961.8 |
| 32 | 180708600153 | 961.73 |
| 33 | 180912300003 | 960.31 |
| 34 | 183341300016 | 959.81 |
| 35 | 181215000009 | 959.4 |
| 36 | 181938800021 | 958.12 |
| 37 | 181939400060 | 958.05 |
| 38 | 181939400319 | 957.99 |
| 39 | 180100200172 | 957.8 |
| 40 | 181619000011 | 957.59 |
| 41 | 180912400032 | 957.36 |
| 92 | 181214900023 | 938.33 |
| 93 | 182922800058 | 937.89 |
| 94 | 181939700157 | 937.62 |
| 95 | 181937900087 | 937.15 |
| 96 | 182922400095 | 937.12 |
| 97 | 181113300027 | 937.08 |
| 98 | 182630200063 | 936.93 |
| 99 | 182630200020 | 936.61 |
| 100 | 183440900151 | 936.22 |

## Bachelor INFORMATIKE

| Nr. | ID MATURANTI | Pikë |
|---|---|---|
| 1 | 181937900427 | 997.50 |
| 2 | 181937900236 | 993.50 |
| 3 | 181758600007 | 993.00 |
| 4 | 182921500043 | 993.00 |
| 5 | 183123800086 | 992.50 |
| 6 | 181960500009 | 991.50 |
| 7 | 181939300098 | 991.00 |
| 8 | 181937900112 | 990.67 |
| 9 | 181939400192 | 990.50 |
| 10 | 181216100009 | 990.00 |
| 11 | 181939700214 | 989.83 |
| 12 | 181937400186 | 989.31 |
| 13 | 181114200064 | 989.00 |
| 14 | 181158200007 | 989.00 |
| 15 | 181215000032 | 989.00 |
| 16 | 181215000159 | 989.00 |
| 17 | 181936300255 | 989.00 |
| 18 | 180708000185 | 988.25 |
| 19 | 181937900017 | 988.00 |
| 20 | 181746600034 | 987.50 |
| 21 | 182232600089 | 987.00 |
| 22 | 181114000027 | 986.67 |
| 23 | 181706600004 | 986.50 |
| 24 | 181807300002 | 986.50 |
| 25 | 181939100202 | 986.50 |
| 26 | 182428300101 | 986.50 |
| 27 | 183123300031 | 986.50 |
| 28 | 181215900005 | 985.50 |
| 29 | 181938800026 | 985.50 |
| 30 | 183341400022 | 985.50 |
| 31 | 181936200182 | 985.25 |
| 32 | 182232600016 | 985.17 |
| 33 | 181706600114 | 984.69 |
| 34 | 183220300025 | 984.55 |
| 35 | 183341300047 | 984.55 |
| 36 | 181939100177 | 984.50 |
| 37 | 181939700308 | 984.50 |
| 38 | 181619000002 | 984.38 |
| 39 | 181937900473 | 983.67 |
| 40 | 181939700323 | 983.58 |
| 41 | 181114000070 | 983.50 |
| 42 | 182629600024 | 983.33 |
| 43 | 181936200217 | 982.83 |
| 44 | 181937900211 | 982.75 |
| 45 | 181216100003 | 982.50 |
| 46 | 183341300109 | 982.48 |
| 47 | 181216700011 | 982.33 |
| 48 | 181939700001 | 982.00 |
| 49 | 181946000037 | 982.00 |
| 50 | 181939400096 | 981.92 |
| 51 | 180100300033 | 981.91 |
| 52 | 181939700274 | 981.75 |
| 53 | 181936200048 | 981.25 |
| 54 | 181214900032 | 981.17 |
| 55 | 181939700255 | 981.17 |
| 56 | 180100300060 | 981.00 |
| 57 | 181216100006 | 981.00 |
| 58 | 181938800037 | 981.00 |
| 59 | 180708000085 | 980.83 |
| 60 | 182922800081 | 980.83 |
| 61 | 183625000173 | 980.75 |
| 62 | 180302400044 | 980.33 |
| 63 | 181746600018 | 980.15 |
| 64 | 181706500091 | 980.00 |
| 65 | 181807300021 | 979.92 |
| 66 | 180708000055 | 979.33 |
| 67 | 182959500002 | 979.17 |
| 68 | 181939400043 | 979.08 |
| 69 | 182034900007 | 979.08 |
| 70 | 180708000169 | 979.00 |
| 71 | 181011600030 | 979.00 |
| 72 | 181317300007 | 979.00 |
| 73 | 183541200074 | 978.93 |
| 74 | 181936100034 | 978.67 |
| 75 | 181939700267 | 978.25 |
| 76 | 181939400198 | 978.00 |
| 77 | 181937900387 | 977.83 |
| 78 | 182630500061 | 977.75 |
| 79 | 180912400026 | 977.33 |
| 80 | 181938600024 | 977.33 |
| 81 | 182953200023 | 977.33 |
| 82 | 180302600164 | 977.17 |
| 83 | 181706600085 | 977.01 |
| 84 | 181937900276 | 977.00 |
| 85 | 181939400352 | 977.00 |
| 86 | 181215000033 | 976.67 |
| 87 | 181939400191 | 976.67 |
| 88 | 181011700133 | 976.50 |
| 89 | 181937900432 | 976.42 |
| 90 | 181939400016 | 976.08 |
| 91 | 180912300002 | 976.00 |
| 92 | 180708000103 | 975.50 |
| 93 | 181958300003 | 975.33 |
| 94 | 181215400013 | 974.92 |
| 95 | 181937900412 | 974.83 |
| 96 | 181935700084 | 974.75 |
| 97 | 181948900001 | 974.08 |
| 98 | 183145200010 | 973.92 |
| 99 | 181936300089 | 973.83 |
| 100 | 181113500324 | 973.68 |
| 101 | 181953800001 | 973.67 |
| 102 | 181706400066 | 973.63 |
| 103 | 183341300027 | 973.53 |
| 104 | 181417600025 | 973.50 |
| 105 | 182922800020 | 973.50 |
| 106 | 183825800020 | 973.33 |
| 107 | 181935800001 | 973.25 |
| 108 | 181937900444 | 973.08 |
| 109 | 182327800093 | 972.92 |
| 110 | 181938800003 | 972.67 |
| 111 | 182326900072 | 972.67 |
| 112 | 181216100005 | 972.50 |
| 113 | 183341300052 | 972.50 |
| 114 | 183625000076 | 972.50 |
| 115 | 181948900002 | 972.16 |
| 116 | 181749000001 | 972.00 |
| 117 | 181807200057 | 972.00 |
| 118 | 181937900513 | 971.92 |
| 119 | 181937900592 | 971.92 |
| 120 | 182526300202 | 971.86 |
| 121 | 181215300009 | 971.75 |
| 122 | 181215000075 | 971.67 |
| 123 | 181746600012 | 971.67 |
| 124 | 181215000156 | 971.42 |
| 125 | 182326900028 | 971.42 |
| 126 | 181215300002 | 971.00 |
| 127 | 181744300008 | 971.00 |
| 128 | 181807300025 | 971.00 |
| 129 | 183341800132 | 970.75 |
| 130 | 182232600056 | 970.58 |
| 131 | 181807300010 | 970.50 |
| 132 | 181946000034 | 970.50 |
| 133 | 182922800097 | 970.50 |
| 134 | 183123700006 | 970.42 |
| 135 | 181158200003 | 970.33 |
| 136 | 183123700063 | 970.25 |
| 137 | 181937900166 | 969.67 |
| 138 | 181956300038 | 968.83 |
| 139 | 181215000028 | 968.75 |
| 140 | 183341300056 | 968.48 |
| 141 | 181939700213 | 968.33 |
| 142 | 181939400093 | 968.11 |
| 143 | 181939700071 | 968.00 |
| 144 | 183724500050 | 967.92 |
| 145 | 181937400137 | 967.91 |
| 146 | 181011700020 | 967.88 |
| 147 | 181939900050 | 967.75 |
| 148 | 181937900415 | 967.58 |
| 149 | 182526600029 | 967.39 |
| 150 | 183145200014 | 967.15 |
| 151 | 181215400002 | 966.92 |
| 152 | 181215000192 | 966.83 |
| 153 | 180708000195 | 966.75 |
| 154 | 181939800007 | 966.63 |
| 155 | 181946000033 | 966.25 |
| 156 | 181705200127 | 965.74 |
| 157 | 182526300200 | 965.74 |
| 158 | 181939700158 | 965.70 |
| 159 | 183440900118 | 965.67 |
| 160 | 183440900173 | 965.42 |
| 161 | 181937900544 | 965.17 |
| 162 | 181938800021 | 965.08 |
| 163 | 182428400025 | 965.08 |
| 164 | 181937900403 | 965.00 |
| 165 | 183341400005 | 964.83 |
| 166 | 180708000174 | 964.75 |
| 167 | 183341300010 | 964.47 |
| 168 | 181939700025 | 964.25 |
| 169 | 180707600021 | 964.08 |
| 170 | 182526500005 | 964.00 |
| 171 | 181939400155 | 963.67 |
| 172 | 181705200105 | 963.60 |
| 173 | 181706600017 | 963.49 |
| 174 | 181619000008 | 963.38 |
| 175 | 182921800016 | 963.08 |
| 176 | 180504800088 | 962.92 |
| 177 | 181939700019 | 962.92 |
| 178 | 181706300020 | 962.58 |
| 179 | 181939500166 | 962.50 |
| 180 | 182630500035 | 962.08 |
| 181 | 181937200012 | 961.92 |
| 182 | 183341300026 | 961.64 |
| 183 | 181706300030 | 961.25 |
| 184 | 182047900005 | 961.08 |
| 185 | 181939300127 | 960.92 |
| 186 | 181114000037 | 960.83 |
| 187 | 181114000084 | 960.83 |
| 188 | 181948200007 | 960.83 |
| 189 | 181215000094 | 960.67 |
| 190 | 181807200229 | 960.58 |
| 191 | 181938600003 | 960.33 |
| 192 | 181937900055 | 960.25 |
| 193 | 182327900048 | 960.17 |
| 194 | 183343600021 | 960.17 |
| 195 | 181011700173 | 959.97 |
| 196 | 181705200161 | 959.94 |
| 197 | 181935700080 | 959.83 |
| 198 | 182326900035 | 959.71 |
| 199 | 181939400167 | 959.67 |
| 200 | 180708600098 | 959.58 |
| 201 | 183123800197 | 959.58 |

DEGA PUNE SOCIALE

| Nr. | ID MATURE | Piket e rrumbullakosura |
|---|---|---|
| 1 | 181807300004 | 970.07 |
| 2 | 183825800006 | 963.06 |
| 3 | 183341300054 | 955.48 |
| 4 | 181939500054 | 954.09 |
| 5 | 181113500018 | 952.36 |
| 6 | 182629600050 | 948.31 |
| 7 | 181749000013 | 946.43 |
| 8 | 183724500038 | 944.86 |
| 9 | 181417600023 | 944.14 |
| 10 | 181113300008 | 943.99 |
| 11 | 183020800024 | 942.19 |
| 12 | 181937200012 | 941.98 |
| 13 | 183123900011 | 941.82 |
| 14 | 181939700152 | 939.39 |
| 15 | 181939800085 | 938.99 |
| 16 | 182232800009 | 937.04 |
| 17 | 182728700011 | 936.54 |
| 18 | 180602700014 | 934.13 |
| 19 | 182232600014 | 933.86 |
| 20 | 182526400046 | 933.45 |
| 21 | 181939400285 | 932.31 |
| 22 | 182526300217 | 932.24 |
| 23 | 181939400120 | 932.12 |
| 24 | 181939400144 | 931.79 |
| 25 | 182922400064 | 931.64 |
| 26 | 181214900021 | 931.55 |
| 27 | 183724500088 | 931.54 |
| 28 | 181936300034 | 929.58 |
| 29 | 181114000004 | 929.21 |
| 30 | 182034600051 | 929.18 |
| 31 | 181807300033 | 928.46 |
| 32 | 181215000147 | 925.24 |
| 33 | 181214900009 | 924.24 |
| 34 | 181937900260 | 924.22 |
| 35 | 183825800003 | 923.72 |
| 36 | 181113500039 | 923.2 |
| 37 | 180403700371 | 923.06 |
| 38 | 181939300236 | 922.98 |
| 39 | 182232600100 | 922.84 |
| 40 | 180708000088 | 922.39 |
| 41 | 182133600166 | 922.2 |

DORESHKRIMI

# DRITËRO AGOLLI: Hedhja poshtë e letërsisë si pjellë e regjimit

*Shkrimi me titull "Etiopianët shqiptarë" si kambanë për çka mohohej*

Letërsia dhe në përgjithësi kultura e krijuar dhe e formuar në këtë gjysmë shekulli, tani mallkohet dhe hidhet poshtë përmes artikujve të shumë gazetave dhe përmes diskutimeve nihiliste të mjaft njerëzve që kanë marrë pamjen e intelektualëve të qëruar. Madje shkohet dhe më larg. Sipas tyre edhe gjuha e njësuar qenkësh pjellë e regjimit dhe u dashka zëvendësuar". Në një shkrim të vitit 1995, Dritëro Agolli e cilëson këtë sjellje si një mendim të huazuar nga intelektualët e Etiopisë. "Në Etiopi në kohën e diktaturës së Halije Salasjesë, deri më 1974, përdorej gjuha ahmarike. Pas rënies së dinastisë, disa intelektualë, gazetarë e shkrimtarë abisinezë filluan të shajnë nëpër gazeta gjuhën ahmarike, pasi me këtë paska folur diktatori dhe duhej zëvendësuar me dialekt tjetër. Edhe letërsia duhej zëvendësuar, pasi ishte krijuar në kohën e dinastisë diktatoriale",-shtonte Dritëroi.

Shkrimi i tij, është risjellë në vëmendje nga e bija, Elona Agolli.

Para shkrimit, ajo vë një shënim. "Duke dëgjuar sot në TV një nga të shumtat marrëzi të radhës (nuk do të kenë askurrëherë fund mesa duket thagmat e çdo epoke e sistemi në Shqipëri, m'u kujtua 'Etiopianët shqiptarë', përkufizim aq i goditur i Dritëroit për këtë racë intelektualësh, mendjendriturish radikalë shqiptarë, që kanë 25 vjet që përsërisin të njëjtin avaz(ndoshta fare pak të modifikuar, pasi tanimë nuk kërkojnë anatemim absolut por njëfarë vulosje, damkosje të veprave letrare të krijuara gjatë sistemit komunist me shënime të formuluara nga kritikë e ekspertë të gjithëditur të epokës së tashme demokratike. Ja çfarë thotë Dritëroi për etiopianët shqiptarë",-thotë Elona Agolli, dhe mandej kujton shkrimin e Dritëroit e argumentet e tij për mohimin e atyre që ishin fituar në të shkuarën.

"Abisinezët shquhen për disa intelektualë mendjendritur, modernë, si shquhemi edhe ne! Këta intelektualë u përpoqën shumë, shanë sa mundën nëpër gazeta, por nuk ia dolën mbanë. Gjuha ahmarike në Etiopi nuk u zëvendësua. Etiopianët edhe sot me këtë gjuhë flasin dhe e çmojnë letërsinë e krijuar edhe më parë. Etiopianët tanë po i vazhdojnë kërkimet e lëna përgjysmë nga vëllezërit e tyre abisinezë, duke ngulur këmbë në zëvendësimin e gjuhës së njësuar dhe të letërsisë së krijuar në këtë pesëdhjetëvjeçar", shkruante Dritëroi, duke vijuar: "Por a po seleksionohet ky gjysmëshekulli letrar? Doemos ai po seleksionohet me shpejtësi. Ai ishte për t'u seleksionuar. Koha me shoshën e madhe në dorë do ta seleksiononte edhe sikur mos kishin ardhur kaq shpejt proceset demokratike. Ne që disa vjet më parë, që në kohën e monizmit kishim filluar t'i harronim shumicën e veprave skematike"-theksonte Agolli. Sipas tij, me lindjen e demokracisë shosha shpejtoi me rrëmbim shoshitjen, pasi shkriu nga akujt mendimin. "Vetë shkrimtarët me vetëdije të lartë krijuese e dinë dhe e kuptojnë se ç'vepra u mbeten, si vëllime dhe si radhë linotipi. Shosha e kohës vazhdon të shoshitë. Asnjë individ nuk mund ta shpejtojë ose ta ndalojë këtë shoshitje. Letërsisë, një, dy, dhjetë apo njëqind individë nuk kanë ç't'i bëjnë, nuk e hedhin dot poshtë"- e mbyllet ai shënimin për etiopianët shqiptarë.

Në të njëjtin vit, ai pyeste se çfarë presupozon lindja e një njeriu duke u përgjigjur se "natyra ndaj çdo qenieje të gjallë vë vetëm një detyrë: rigjenerimin, përtëritjen e gjeneratave. Edhe ndaj kësaj qenieje të gjallë që quhet njeri, natyra kërkon vetëm një gjë: rigjenerimin. Kur lindet një njeri prindërit çlirohen nga një detyrë e madhe e natyrës. Nuk ka rëndësi për natyrën se nga cili vend ishte femra që u bashkua me mashkullin, ishte nga Shqipëria apo nga Zanzibari, mjafton që kjo lindi. As ka rëndësi për natyrën se këtë njeri e la kjo femër në vendin që lindi, apo e mori me vete, fjala vjen, në Zanzibar. Rëndësi ka që ajo e kreu detyrën ndaj natyrës". Shtonte se lindja e njeriut është një akt i madh konkludiv, një nukleo detyrash dhe premtimesh ndaj gjithësisë, është një nukleo i thesarit të natyrës, që vjen për të dhënë premtimin: "Unë do të ripërtërij, unë, kjo nukleo, do të shtojë një gjeneratë për t'ia pasuruar thesarin natyrës". Sipas Dritëroit ky është kuptimi i parë i lindjes së njeriut, kuptimi biologjik i barabartë me të gjitha qeniet e gjalla. "Ndërsa kuptimi shoqëror dhe njerëzor i kësaj lindjeje është i shumëfishtë, është një akt dhe një nukleo që i përmbledh të gjitha: kërkesën e madhe të natyrës, kërkesat e prindërve, kërkesat e fisit, kërkesat e atdheut, kërkesat e shoqërisë. Njeriu lind që të trashëgojë ato që kanë lënë paraardhësit, lind për t'u bërë zot i këtyre trashëgimive, lind për t'i pasuruar ato dhe ajo që është më e madhja, lind për të transformuar. Bërtitja e tij që sapo bie nga mitra e nënës së vet është një bërtitje që përmban shumë klithma dhe janë klithma kolosale, megjithëse nuk i kuptojmë. Kafshët e porsalindur, e porsarëna nga mitra, nuk bërtasin. Shtron se një viç i porsalindur nuk bërtet, siç bërtet njeriu i porsalindur. Me këto britma ai shpreh protestën dhe kontestimin e pandërgjegjshëm spontan dhe të pakuptueshëm. Këto britma thonë: Unë linda. E dëgjuat që linda? Unë linda të transformoj. Mua kjo botë e krijuar deri tani nuk më kënaq, prandaj po bërtas: unë erdha të transformoj. Unë kundërshtoj. Ju


anëtarëve të saj lexojnë
100 mijë shkronja në mi
nutë, dmth një libër
prej 250 faqesh ata e
lexojnë në tetë minut
Më i shpejti në këtë sh
gatë është një korean 10-vj
çar, që lexon 1.200.000
shkronja në minutë, dmth
një libër rreth 400 faqesh
[shtypi]

dua përmes kundërshtimit. Për të lindja e njeriut presupozonte, pra, zotërimin e vlerave të trashëgimisë dhe transformimin e tyre. Njeriu lind që të bëhet zot i gjithçkaje, duke kundërshtuar dhe duke transformuar gjithçka.



## 73 ditë protestë, kur fiken dritat në teatër

*Neritan Liçaj: Ke thyer kokën tri herë në këtë teatër, kjo e fundit është e vështirë*

Në datën 26 gusht, në të 72-ën ditë proteste të rregullt çdo mbrëmje në sheshin mes dy teatrove, dritat u shuan. Si në fundin e një shfaqe, kur dritat fiken e perdja mbyllet, për të thënë që "është ky fundi", u duk se mesazhi qe i njëjtë.

"Teatri Kombëtar dhe Teatri Kombëtar Eksperimental kanë që në orën 10.00 pa drita. Dhe kjo një arritje e madhe e qeverisë dhe platformës për modernizim të bashkisë. Aaaa këta janë mjeranë. More dallkaukë. Me këto metoda idiote do e mposhtni teatrin ju?! Harrojeni aty do jemi me kamera dhe rrjete sociale dhe me qirinj deri sa t'ju marrim erzin siç po jua marrim. Udhëtim të mbarë për në gropën septike që keni hapur me duart tuaja", shkruante Neritan Liçaj një prej aktorëve të qëndresës 70 ditëshe në mbrojtje të godinave dhe kundër projektit që i hap rrugë shembjes së dy teatrove për të ndërtuar një dhe ngritjes krah tij të një serie kullash.

Aleanca për mbrojtjen e teatrove e sheh fikjen e dritave si mesazh. "Dje, qeveria bëri provokimin e parë para fillimit të sesionit të ri parlamentar. Gjatë gjithë ditës ndërpreu energjinë elektrike në Teatër, pjesë e një strategjie për t'i lodhur dhe demoralizuar protestuesit", shkruhej në faqen




e tyre. Ndërsa në takimin e mbrëmjes, Liçaj mori fjalën për të thënë se: "Nuk na projekton nder e dinjitet të marrurit me fate personale të secilit prej nesh. Nuk jemi këtu për këtë. Secili prej nesh ka rrugëtimin e vet në jetë, ka fatet e veta. Jemi këtu kundrejt një kryeministri me një qeveri. Doja t'i drejtohesha shtatlartësisë së tij, mësuesit të vizatimit, që po projektohet si adoleshent, që vdes të bëjë një foto me Ronaldon. Ai ka mundësi, sepse paguan që ta bëjë foton me Ronaldon. Ke ardhur si ministër i Kulturës te këto muret këtu (shtrin dorën nga teatri).E theve kokën. Ta falëm. Vazhdove. Erdhe si kryetar bashkie, prapë të këto mure e theve kokën. More krisjen tënde të parë si politikan. Tani është e treta e vërteta, e theve kokën edhe kësaj radhe. Por tani është e treta e vërteta dhe ne nuk ta falim kurrë. Harroje. Kësaj radhe do ulesh në gjunjë, do kërkosh të falur dhe do i bësh gjithë shërbimet kësaj zonjës së vjetër këtu (shtrin dorën nga teatri) me para publike dhe jo si të do qejfi ty. Nëse nuk e bën, nuk të ndahemi, ose do të të rrëzojmë, o nuk ka se, se na e ke sjellë këtu(në majë të hundës). Lëri çitjanet, atletet e fotot. Eja qeveris siç duam ne, jo siç të pëlqen ty. Po të përgjigjem me një batutë të filmave shqiptarë: 'Thirri mendjes o rr..ë'. Dhe mos m'u kthe me batutën e Shabanit, se e di mirë ti se ç'bëri Shabani. Po të plas nga mesazhi i filmit, mos u tremb se je edhe frikacak, trembesh përnjëherë. Ndaj thirri mendjes o rr...."

Të dielën, në sheshin e protestës, u paraqit një vështrim interesant mbi lëvizjet politike që kanë tronditur Egjiptin që nga fillimi i Pranverës Arabe "Sheshi", një dokumentar nga regjisori egjiptiano-amerikan Jehova Noujaim që u shfaq, ndjek një numër individësh, ciklet e shpresës revolucionare, të pasuar nga trazirat që nganjëherë kthehen të pikëllueshme dhe vdekjeprurëse.

ÇKA NUK DO TË DUHEJ TË HANI ÇDO DITË


# SUMMER pages

SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE

E marte 27 Gusht 2018




## ADELINA TAHIRI BËHET NËNË, NDAN EMOCIONET ME FANSAT



## "Vër peshqir aty, o rrushi, se le nam", ja reagimi i Oriolës"

BULEVARDI POLITIK



- Haradinaj i bindet Ramës, heq kollaren në Samitin e Ballkanit në Durrës
- I veshur me kamuflazh dhe mjekër, Saimir Tahiri provokon nga "çatia e Labërisë"
- Tha se nuk pinte të gazuara, publikohen faturat e Pacollit: Qindra 'Schwepps'
- Diplomaci me prodhime deti, Erdogani fton Putinin në restorant peshku



Kryebashkiakja e Patosit : Pengu më i madh është koha ndaj familjes

# RAJMONDA BALILAJ:

## Politika është pasion, sfidat do të jenë të mëdha

*"Ime bijë ka prirje të ndjekë hapat e mi"*

### Kryebashkiakja e Patosit : Pengu më i madh është koha ndaj familjes

# RAJMONDA BALILAJ:

# Politika është pasion, sfidat do të jenë të mëdha

*"Ime bijë ka prirje të ndjekë hapat e mi"*

Egla Xhemali

Patosi ka pësuar ndryshime të mëdha këto vitet e fundit. Gjithçka i përngjan një ylberi që ndërthur me harmoni investimet e bëra, ngjyrat në lagje si dhe mikpritjen e banorëve dhe të kryebashkiakes. Mes impenjimesh të shumta zonja Rajmonda Balilaj gjeti pak kohë edhe për ne, për të na rrëfyer për "Summer Pages" të "Gazeta shqiptare" pasionin e madh që ka për politikën, punët e mira dhe përkushtimin që ka për qytetin e Patosit, pushimet me familjen si dhe besimit që ka për t'i realizuar të gjitha objektivat deri në fund. Ajo nuk rresht së punuari edhe gjatë ditëve të pushimeve ku për të disatin vit rresht zgjedh bregdetin e bukur të Himarës. Për të është shumë e rëndësishme që nesër kur të kthehet mbrapa në kohë të ketë lënë vepra të mira dhe t'u ketë shërbyer me devotshmëri banorëve. Ajo e pret çdokënd buzagaz dhe me shpirtin plot për ta ndihmuar. Kështu ka rritur që të fitojë për dy mandate zemrat e të gjithë njerëzve në Patos, që e falënderojnë për të gjithë përkushtimin këto vite. Balilaj thotë se është e ndjeshme ndaj çdo lloj problematike që hasin qytetarët. Sa i përket raporteve me fëmijët ajo ka zgjedhur të jetë një mikemama që i kupton dhe flet për gjithçka me fëmijët. Për të familja është frymëzimi më i madh dhe streha e ditëve të vështirë. Zonja Rajmonda pohon se do i mbështesë fëmijët nëse do të duan të përfshihen në politikë dhe se beson tek të rinjtë. Nëse qytetarët do e votojnë përsëri puna dhe përkushtimi i saj do jetë edhe më i madh për të realizuar ato projekte që ende nuk kanë marrë formë.

**Ju jeni ekonomiste në profesion. Pse i keni hyrë politikës?**

Politika nuk do ndonjë profil të caktuar. Unë shpesh herë e them që nuk jam politikane e prerë, po menaxhere. Drejtimin e bashkisë e kam quajtur më shumë menaxherial pasi duhet të drejtosh politikat e zhvillimit të territorit dhe pikërisht për këtë nuk do të merresh me politikën në vete, po me një harmonizim politikash për zhvillimin e atij territori ku ti ke marrë përsipër ta bësh këtë gjë. Unë besoj te politika e drejtë. Është mirë që ai organizim, të cilit i ke besuar dhe pret ndryshim të të mos zhgënjejë.

**Sa e vështirë është të jesh kryebashkiake?**

Unë jam në mandatin e dytë dhe më duket sikur kësaj pyetje i ka kaluar pak koha, për shkak të rutinës ndoshta. Sigurisht që është e vështirë pasi duhet të orientosh politika zhvillimi të një komuniteti, i cili nuk ka shumë mundësi qofshin ato financiare, por edhe vet këto bashkitë e vogla në tërësinë e tyre kanë më shumë probleme se bashkitë e mëdha. Nuk është numri i popullsisë ai që përcakton shkallën e vështirësisë, por janë problemet që ndodhen aty dhe ato të presin ty për t'i zgjidhur. Më të shumta janë nevojat nga mundësitë, por sfida kjo është, që të përballosh sa më shumë nga nevojat që ka komuniteti me një grusht buxheti që kanë pushtetet vendore dhe sidomos bashkitë e vogla.

**Ka pasur ndonjë moment që keni dashur të hiqni dorë nga detyra?**

Janë të shumta momentet e janë pikërisht ato që kanë më të lartë ndjeshmërinë njerëzore. Ajo që të prek më shumë është çështja e punësimit dhe tjetra më pak e ndjeshme këtu në Patos çështja e strehimit. Çështjet e punësimit janë çështje të trashëguar edhe nga sistemi, që vinë të mbartura nga ai sistem ku punën ta gjente shteti, po edhe mundësitë e pakta të punësimit apo të zhvillimit të ekonomisë janë prezente në bashkitë të nivelit jo shumë



të zhvilluara. Shpeshherë në takimet që kam me qytetarët ky është problemi më i madh që ti çdo ditë në sallën e pritjes ndeshesh. Padyshim, pa burim të ardhurash në familje nuk do jesh i lumtur nëse bëhet një rrugë, shkollë apo lulishte. Është interesi i vogël familjar, sepse, nëse nuk kemi ekonomi, nuk kemi si të adaptohemi në ekonominë e zonës ku je bashkëqytetare me komunitetin ku jeton. Këto janë momente të vështira. Kur kam pjesë nga ekipi im në pritje, pasi ikën qytetari i drejtohem dhe i them "Si do veproje ti nëse do të ishe në vendin tim?" Ka raste kur vijnë kryefamiljarë që nuk kanë asnjë të ardhur, që kanë fëmijë për të ushqyer ose ata familjarë që dhe pse marrin ndihmë ekonomike ajo si përmbush të gjitha nevojat e tyre. Këto janë më së shumti problemet me të cilat ndeshesh se pjesa tjetër është diçka që unë e kam vendosur që para disa vitesh, kur kam pranuar këtë lloj sfide që di ta bëj e që kam dy mandate që përballem. Pjesa tjetër është pjesa e kënaqësisë që ti ndjen kur merr atë që pret nga qytetarët, kur ti zhvillon zonën në infrastrukturë apo dhe në shërbime dhe e merr shumëfish kur thonë fjalë të mira qytetarët.

**Politika është më shumë pasion apo profesioni juaj?**

Politika është pasion nuk është profesion. Të jetë profesion është më shumti kjo pjesa e menaxhimit të problemeve. Nuk ka rëndësi se ku menaxhon, se sa e madhe është pjesa që ti ke marrë përsipër të bësh. Unë rritem bashkë me stafin tim apo edhe me projektet me të cilat punojnë pushtetet vendore për të rritur kapacitetet dhe burimet njerëzore të stafeve. Askush nuk mund të jetë i prerë apo i bërë që në momentet e para që pranon të drejtosh. Rritesh profesionalisht dhe në shumë aspekte, ndaj them se politika është më së shumti pasion.

**Ju jeni nënë e tre fëmijëve. Çfarë raportesh keni me ta?**

Familja është pjesa më mbështetëse, sepse kur mërzitesh, kur lodhesh është ajo ku ti shkon e bisedon. Kur do të të dëgjojnë apo dhe kur do të marrësh mendime familja është baza ku ti do marrësh fidbekun e tyre. Pastaj fëmijët janë pjesa më mbështetëse pasi ke gërshetimin e brezave. Do të marrësh mendimin e fëmijëve dhe për shkak të moshës që ata kanë, këndshtrimin e ndryshëm që kanë për zhvillimin dhe tërësinë e gjërave. Ndërsa, marrëdhëniet e mia me fëmijët që shumë kohë më parë, jo vetëm tani si kryebashkiake kanë qenë raporte të drejta. Kam qenë gjithmonë me faktin që ato t'i shprehin mendimet e tyre. Edhe kur kanë gabuar ata janë gati të marrin mendimin tek unë. Këtë faktikisht do ia drejtoja dhe prindërve të rinj që të jenë open mind me fëmijët pasi është mënyra më ë mirë që ata t'i kesh gjithmonë në krah, t'i kesh gjithmonë aty edhe kur nuk janë fizikisht. Fëmijët e mi tanimë janë të rritur e kanë dalë në rrugët e jetës, por gjithsesi i kam pasur dhe vazhdoj t'i kem bashkëbisedues shumë të mirë për problemet që ata dhe unë kam në mënyrë reciproke. Vajza është më mbështetëse për të më dhënë hov dhe forcë. Unë e përmend shpesh këtë dhe ajo ma bën kritikë duke më thënë pse më përmend vetëm mua, por kështu është e vërteta, në fakt. Në momentet e para që unë kam filluar fushatën për t'u bërë kryetare bashkie, shumë herë ndeshesha me opinione ose dhe me shkrime të ndryshme dhe ishte vajza ajo që më ka thënë "Stop, ti nuk do të lexosh asgjë, do ecësh përpara!' Familja është burim frymëzimi në të gjitha rrugët që ke zgjedhur.

**A keni pengje?**

Në fakt, ndahen edhe këtu pengjet, pengje në kuptimin e realizimit tënd personal apo ndaj fëmijëve. Pengje kam ndaj fëmijëve dhe ndaj bashkëshortit. Duket sikur këto vite që janë bërë shumë tanimë nuk jam dhe aq prezente tek ata. Mua, në fakt, më ka ardhur në kohë futja në politikë dhe në këtë sipërmarrje pasi ata tani janë më të rritur dhe më të kuptueshëm. Nëse do të ishin më të vegjël do kisha dhe më shumë pengje. Femrat kanë shumë energji për t'iu përgjigjur shumë drejtimeve, problemeve e për këtë ndihem e lumtur.

**Përpos punës, çfarë e rrëmben kohën tuaj?**

Në fakt, kjo pjesa e të qenurit kryetare bashkie të merr shumë kohë edhe kur nuk jam në zyrë, edhe kur jam në terren edhe kur jam me pushime. Kur je drejtuese telefonatat dhe komunikimi në tërësi të ndjekin e nuk ke hapësira mjaftueshëm për të pasur kohë të lirë. Sapo gjej kohën ia dedidikoj familjes. Bëj pazar edhe këtë pjesë e bëj vet(qesh), por ndonjëherë është dhe pjesë e çlirimit nga lodhja që ke gjatë ditës. Leximi është një nga momentet që unë dua të humbas pjesë e lodhjes. Ka momente që unë përqendrohem te librat artistik apo dhe filozofik.

**Do të donit që fëmijët tuaj të përfshiheshin në politikë?**

Unë nuk i kam mbajtur larg ndaj gjërave që duan ti bëjnë. Këtë kam pasur si synim edhe për profesionin që ata kanë zgjedhur nuk i kam orientuar, por i kam

# ADELINA TAHIRI BËHET NËNË, NDAN EMOCIONET ME FANSAT

Më në fund pritjes së ëmbël i erdhi fundi. Adelina Tahiri Kishte nja arsye më tepër gjatë ditës së djeshme për të qenë e lumtur. Këngëtarja shqiptare është bërë nënë për herë të parë në moshën 27-vjeçare. Ajo ka sjell në jetë një djalë, të cilin e ka pagëzuar me emrin Joni. Përmes rrjeteve sociale bukuroshja ka publikuar edhe një fotografi të dorës së djalit. "Mirë se erdhe në jetë princi i vogël Joni", ka shkruar në llogarinë personale në "Instagram", Tahiri. Theksojmë se muaj më parë është martuar me afaristin dhe avokatin maqedonas, Serjozha Markov. Për momentin Adelina i është përkushtuar tërësisht familjes, por besohet se gjatë vitit të ardhshëm do të sjell projekte të reja muzik



# "VËR PESHQIR ATY, O RRUSHI, SE LE NAM", JA REAGIMI I ORIOLËS"

Oriola Marashi është një nga modelet më të komentuara në mediat rozë. Ajo di të jetë gjithmonë në qendër të vëmendjes me pozat e saj provokuese, por edhe me komentet pikante që shkëmben me fansat e saj. Së fundmi në një foto të postuar në "Instagram" ku shihet e veshur me bikini të vogla, ku vlen të thuhet se duket shumë seksi, një fans ka dashur të bëjë një shaka me të. 'Vër peshqir aty, o rrushi, se le nam", i shkruan ai, ndërkohë ky koment i ka tërhequr vëmendje edhe Oriolës, e cila ia ktheu kështu: "Ok, rrush"..







# TAYNA KOPJON NOIZYN NË KËTË DETAJ





Tayna është një nga reperet më 'IN' të momentit dhe që në debutimin e saj në tregun muzikor shqiptar, ia bëri BOOM. Ajo u bë e njohur në këngën "Columbiana" me Don Phenom, e për të vijuar suksesin e saj me "Shqipe". Por ajo nuk u ndal me kaq dhe para një jave publikoi këngën e saj më të fundit nën titullin "FAKE" e cila në vetëm një javë numëron mbi 3 milion klikime, që tregon edhe një herë se Tayna është artistja më në zë e momentit. Mirëpo siç duket te kënga e saj e re, ajo ka kopjuar pak a shumë një pjesë të tekstit të Noizyt në këngën "Big Body Benzo" ku thotë: "Nuk ma bleu as mami as babi, i bleva vet". Ndërkohë që te kënga "Fake", Tayna thotë: "Osht shum let m'u shit gangster / Kur ty krejt t'i ka ba babi/ Femën krejt i mrriva vet". Këtë detaj e kanë vënë re dhe faqet e ndryshme në 'Instagram' dhe menjëherë kanë publikuar videot.

thënë çfarë do ti të bëhesh. Me prirje për politikë shoh vajzën e dytë atë që e përmenda pak më parë që e kam pasur mbështetje të madhe në disa periudha të cilat kanë pasur nevojën e një suporti, ndërsa dy të tjerët nuk i shoh në drejtim të politikës. Do të më pëlqente që të merreshin me politikë. Këtë ia them dhe shumë të rinjve të tjerë pasi duam të ndryshojmë shumë gjëra në politikë. Politika duhet parë si gogol, por si një gjë e mirë që i duhet një vendi për orientuar ato politika që kanë të bëjnë me zhvillimin e një kombi. Në Shqipëri, por dhe në vendet të tjera ndoshta marrja me politikë nuk është parë me sy të mirë, por unë jam për të mbështetur shumë të rinj për t'u marrë ata me politikë të mirëfilltë dhe për të bërë politika të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin e një kombi. Nëse fëmijët e mi do kishin dëshirën do i mbështesja, sepse dua të bëjnë ndryshimin dhe të jenë pjesë e tij.

**Si e kaluat këtë verë? Ku zgjodhët të pushoni?**

Në fakt, ishin shumë pak ditë. Unë zgjedh gjithmonë që të pushoj bashkë me familjen brenda Shqipërisë dhe Himara është një nga vendet e mia të preferuara për të bërë pushime pasi ka variacione. Mua më pëlqen të lëviz dhe Himara ta ofron këtë gjë pasi ka disa gjire, disa plazhe tek të cilat mund të shkosh te secili prej tyre. Kështu që ndoshta më ka shërbyer për të rinovuar energjitë dhe për të filluar muajin shtator që kërkon mjaft impenjime. Puna nuk ka reshtur asnjë ditë edhe përgjatë këtyre ditëve.

**Pse do i kërkonit qytetarëve dhe një mandat tjetër?**

Përgjatë këtyre ditëve ia kam bërë shpesh këtë pyetje vetes. E kam thënë dhe më parë që ai që merr përsipër të bëj një sipërmarrje i duhet kohë për të realizuar atë që ka ndërmend të bëj. Sidomos pas reformës territoriale ku ne kemi pasur më shumë territore dhe komunitete të ndryshme për t'u shërbyer që dallojnë nga njëra njësi tek njësia tjetër. Nuk kanë qenë të mjaftueshme katër vite për të nxjerrë në pah atë që ti me të vërtetë do të realizosh. Të duket si një projekt i lënë përgjysmë. Sigurisht që nuk do të ketë pafundësi pasi janë mandate, por nëse



mua do të më besohej edhe një mandat tjetër mendoj se do të mbyllej projekti i asaj që kam ideuar. Ka projekte që qëndrojnë aty për të gjetur dritën e financimit, ka projekte të cilat sapo kanë filluar e duhet të përfundojnë. Kur ti ikën nga një detyrë me mbresat më të mira, është ndjesi shumë e mirë kam përshtypjen. Drejt një rruge pa kthim nuk jemi. Vjen një moment që bën retrospektivë në jetën tënde dhe do të ndihesh mirë kur njerëzit do të kujtojnë për gjurmët që ke lënë. Unë që në mandatin e parë kam luftuar me buxhetin e bashkisë që ishte shumë pak për të pretenduar realizimin e gjërave të mëdha. Gjithsesi fakti që këtij komuniteti i kanë munguar investime të mirëfillta dhe kur bëjmë një rrugë qytetarët janë aty për të falënderuar. Kemi punuar shumë edhe për fshatrat pasi aty janë edhe problemet më të mëdha. Kur ti u çon një rrugë të shtruar me standarde bëhet fjalë, fillon që dhe koncepti për jetën të jetë ndryshe. Edhe vet fshati merr zhvillim, po dhe ato që e prekin investimin e konceptojnë ndryshe edhe vazhdimin e të jetuarit në fshat apo lagje. Patosi ka shumë probleme të tjera, përveç shëtitores që e kemi realizuar, unazën dhe rrugë të tjera të brendshme ka zona informale, blloqe të tjera që presin të zhvillohen, po dhe infrastruktura në fushën e kulturës. Sa i përket arsimit jemi në zhvillim mesatar pasi kemi investuar në dy shkolla dhe në tre të tjera sapo kemi çelur prokurimet kështu që po ecim në këtë drejtim. Në vetvete arsimi kërkon një hov më të madh që do e ketë në vitet që do të vijnë. Fusha për të vepruar ka plot edhe pse shohim disa gjëra të mira. Punë do të ketë shumë, sfidat do të jenë edhe më të mëdha. Duke rritur standardin e infrastrukturës sigurish që dhe rriten kërkesat e qytetarëve dhe ata e ndjejnë që duhet të kërkojnë më shumë. Atje ku nuk ka pasur investim njerëzit rrinë më një lloj mosbesimi dhe kur shkon investimi kërkesat janë shumë herë më të larta. Unë shpeshherë e them që kjo është një shenjë e mirë, kur njerëzit fillojnë të kërkojnë pasi bëhen kështu edhe më të ndjeshëm.



# ÇKA NUK DO TË DUHEJ TË HANI ÇDO DITË

Më në fund keni vendosur të hani ushqim të shëndetshëm, por ka mundësi të bëni gabime të vogla duke menduar se po i bëni gjërat e duhura.
Pikërisht këto gabime të vogla mund ta pengojnë procesin e dobësimit, për shkak që kanë ndikim të madh në pamjen, shëndetin dhe sjelljen tuaj.
Disa ushqime, të cilat mbajnë epitetin si shumë të shëndetshme, nuk do të duhej t'i konsumoni për çdo ditë.

*NJË GOTË QUMËSHT*

- Edhe pse qumështi është një shtojcë e shëndetshme e shuajtës, ka mundësi që pikërisht ai është fajtor për dobësim të ngadalshëm. Nëse jeni mësuar të pini qumësht para gjumit, gjatë mëngjesit, ose gjatë ditës, provoni të mos e pini atë për një muaj. Nëse ndieni ndryshim - jeni më pak të ngacmueshëm, keni më shumë energji, vëreni humbje të peshës, lëkura juaj është më e pastër dhe më e shëndetshme - ndoshta kjo është zgjidhja e problemeve tuaja.





*ËMBËLSIRE PAS NGRËNIES*

- Pothuajse nuk ka njeri që nuk e ka këtë shprehi. Gjithmonë dëshirojmë të hamë diçka ëmbël pas ushqimit. Fatkeqësisht, kjo është krejtësisht e panevojshme dhe shumica nga ne e dimë, mirëpo qëllimisht e injorojmë. Nëse këtë e bëni çdo ditë, atëherë e kuptoni se jeta do të ishte më e lehtë po të zvogëlohej konsumimi i sheqerit. Le të jetë deserti diçka me të cilin gostiteni një herë në javë, më së miri gjatë fundjavës, kur keni kohë të lëvizni dhe t'i digjni kaloritë e ngrëna.

*KARBOHIDRATET E RËNDA*

- Sa herë e keni ndier nevojën për të grimcuar diçka mes drekës dhe darkës e në fund e keni përmbushur këtë nevojë dhe keni ngrënë çfarëdo qoftë pa menduar a është e shëndetshme dhe e nevojshme? Sandviç, patatina ose diçka të ngjashme. Është shumë e rrezikshme nëse e bëni çdo ditë: në këtë mënyrë nuk ka humbje peshe, vështirë që do ta ruani peshën tuaj trupore, e sigurisht që nuk do të ndiheni më mirë në një plan më afatgjatë. Nëse me të vërtetë lëshoni pe për dëshirat e stomakut, atëherë frutat arrore janë zgjidhja.



*PATATJA*

- Një studim i kryer së voni i ekspertëve nga Harwardi përfundimisht ka dëshmuar se në një afat më të gjatë patatja ju bën të trashë. Patatja është e shëndetshme, mirëpo të tepruarit me çfarëdo qoftë asnjëherë nuk është i mirë, e vetë patatja mund të imponohet shpesh në atë që hamë deshëm apo s'deshëm. Zvogëloni konsumimin e saj, shtoni konsumimin e perimeve të freskëta të papërpunuara dhe çdo gjë do të jetë në rregull.

*TË ASHTUQUAJTURAT "MEZE TË SHËNDETSHME"*

- Në esencë ato nuk ekzistojnë fare. Më mirë është që të ngopeni mirë me ushqim të vërtetë, i cili ka vlera të plota ushqyese.

# Haradinaj i bindet Ramës, heq kollaren në Samitin e Ballkanit në Durrës

Në nisje të samitit të kryeministrave të Ballkanit i pari që mbërriti dje ishte kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, me të cilin i pari i qeverisë shqiptare Edi Rama nuk i kurseu batutat, ndërsa e këshilloi të hiqte kollaren. Pak minuta më vonë, ndërsa liderët u ulën në tryezën e diskutimeve kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj u shfaq pa kollare. Nuk dimë nëse kjo ndodhi pas këshillës së bërë nga Rama, apo Haradinaj u vu disi në siklet për faktin se askush prej të ftuarve nuk mbante kollare në takimin informal, por në tryezë ai i u shfaq pa kollare.



# I veshur me kamuflazh dhe mjekër, Saimir Tahiri provokon nga "çatia e Labërisë"

Ish-Ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, duket se po e shfrytëzon më së miri tërheqjen nga jeta politike. I njohur për shpirtin e aventurës, larg zhurmës së kryeqytetit dhe tërësisht i shkujdesur dhe çliruar nga veshjet zyrtare, ai shfaqet mbi majën e Kendrevicës në Labëri, 2122 metra mbi nivelin e detit. Në foton e postuar në faqen e tij në 'Fb', Tahiri shihet i veshur me një kostum kamuflazh dhe mjekër.



BULEVARDI POLITIK

*Na merrni seriozisht!*

# Tha se nuk pinte të gazuara, publikohen faturat e Pacollit: Qindra 'Schwepps'




Më herët mediat kishin publikuar disa shifra, të cilat tregojnë se zëvendëskryeministri i Kosovës, Behgjet Pacolli, vetëm gjatë një muaji kishte porositur rreth 344 pije të llojit Schweppes. Prej këtyre 182 kishin qenë tonik ndërsa 162 bitter lemon. Për më tepër, të gjitha këto janë paguar nga paratë e shtetit. Ndaj publikimit të këtyre shifrave ka reaguar Pacolli, i cili është munduar të hedhë poshtë lajmin duke thënë se ai nuk konsumon pije të gazuara. Pacolli tha se informacionet në lidhje me këtë nuk janë të sakta dhe se dikush mund të ketë abuzuar me emrin e tij. Ai madje ftoi prokurorinë që të nisë hetim në lidhje me këtë. Mirëpo, faturat e publikuara nga kallxo.com hedhin poshtë reagimin e Pacollit ku thotë se informacionet në lidhje me këtë nuk janë të sakta.

# Diplomaci me prodhime deti, Erdogani fton Putinin në restorant peshku

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin dhe homologu i tij turk, Recep Tayyip Erdogan së shpejti do të takohen për të diskutuar marrëveshjen e sistemeve anti-ajrore S-400... duke ngrënë peshk në një restorant të veçantë në Stamboll. Takimi vjen në kulmin e përplasjeve Turqi-SHBA, si për të acaruar edhe më shumë Presidentin amerikan Donald Trump. Por historia e restorantit të peshkut nuk lindi rastësisht. Në atë kohë, Putini i kujtoi homologut të tij turk që dikur Erdogani e ftoi atë të hanin së bashku në një restorant peshku. Kur Erdogani theksoi se ftesa qëndronte ende, Presidenti rus theksoi se duhet të zgjidhet fillimisht çështja me eksportet e mishit në Turqi. Në fund të korrikut Rusia filloi eksportet e mishit në Turqi dhe Presidenti turk i hapi rrugë takimit në restorantin e peshkut.



Opinioni i Ditës

# Referendumi për emrin në Maqedoni dhe ndikimi i tij në rajon

Nga Mujë Bucpapaj

*(vijon nga faqja 1)*



... "Marrëveshjen e Prespës."

Pas marrëveshjes së Ohrit të gushtit 2001 që siguroi një bashkëjetesë me shqiptarët në një shtet, Maqedonisë iu imponua një tjetër marrëveshje me Greqinë (që mban emrin e një tjetër liqeni), për t'i siguruar asaj një bashkëjetesë me Greqinë në forumet ndërkombëtare ku Maqedonia dëshiron të ankorohet.

Nëse në Marrëveshjen e Ohrit shqiptarët ishin aktorë dhe palë, në Marrëveshjen e Prespës dhe në përgjithësi në bisedimet e gjata të Maqedonisë me Greqinë u lanë jashtë, thua se nuk ishin qytetarë të atij shteti. Pas ardhjes në fuqi të Zaevit shqiptarët patën një rol periferik.

Ky anashkalim, ose përjashtim u ka mohuar shqiptarëve një të drejtë legjitime si qytetarë të atij shteti, por, nga ana tjetër, nuk i detyron shumë shqiptarët që të marrin pjesë në këtë referendum, pasi edhe emërtimi i ri, i republikës maqedonase nuk shpreh asgjë shqiptare edhe pse ata përbëjnë gjysmën e popullsisë së vendit.

Në rastin më të mirë shqiptarët etnikë në Maqedoni mund t'i përgjigjen këtij injorimi tradicional të shtetit maqedon ndaj tyre, duke bllokuar referendumin, duke kërkuar që emri i republikës së re të ketë edhe shprehjen shqiptare, në togfjalëshin emërtues (Maqedonia e Veriut).

Në fakt, negatorët grekë gjatë vitit të fundit të bisedimeve ndërshtetërore, patën propozuar si emër të përshtatshëm edhe "Republika sllavo- shqiptare e Maqedonisë."

Tashmë kjo gjë është shumë vonë dhe pyetja është nëse shqiptarët do të duhet të marrin pjesë në referendumin e 30 shtatorit, apo jo?

Në fakt, pyetja më e drejtë do të ishte: a do të duhet që shqiptarët ta shpëtojnë edhe njëherë ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë (FYROM), siç është njohur deri tani në nivel ndërkombëtar.

Nëse Marrëveshja e Ohrit, ashtu e gjymtuar dhe shpesh e pashpresë reale, ia zgjati jetën Maqedonisë, tani në kushtet e bojkotit të opozitës së djathtë në vend, shqiptarët janë duke e shpëtuar përsëri Maqedoninë duke marrë pjesë në referendumin e 30 shtatorit.

Nëse shqiptarët bojkotojnë referendumin, ai humbet dhe për pasojë kemi shndërrimin e Maqedonisë përfundimisht në një shtet pa perspektivë europiane dhe atlantike dhe e ardhmja e saj do të ishte në pikëpyetje.

Ashtu siç do të ishte në pikëpyetje edhe fakti nëse shqiptarët do të duhej që edhe më tej të jetonin brenda një shteti të përçarë, pa identitet, pa busull orientimi, me institucione të dobëta që nuk garantojnë liritë themelore njerëzore, kombëtare dhe politike

Ky do të duhej të ishte një qëndrim i gjithë faktorit politik shqiptar, i shoqërisë civile, mediave dhe rretheve universitare akademike.

Dështimi i referendumit do të sillte një krizë me ndikime rajonale, pasi do të nxirrte në sheshet e Maqedonisë trupën filoruse dhe filoserbe, me protesta për të rrezuar qeverinë pro perëndimore të Zaevit, si dhe rifilluar proceset diferencuese ndaj shqiptarëve për t'i rikthyer ata në gjendjen fillestare, si qytetarë të dorës së dytë në këtë shtet.

Kjo do të kishte për pasojë reagimin e shqiptarëve në Maqedoni, të cilët do ta shihnin ekzistencën e tyre të kërcënuar nga rizgjimi i politikave të vjetra, përjashtuese dhe shtypëse ndaj tyre dhe zor se vendi do t'u shpëtonte përplasjeve etnike.

Intoleranca e theksuar etnike dhe albanofobia është shfaqur qysh tani, një muaj para referendumit. Kërcënimet për vdekje që mori një nga politikanët më të moderuar në Maqedoni dhe në Ballkan si Ziadin Sela, është një dëshmi e qartë e shtypjes së shqiptarëve atje. Sela u kërcënua vetëm pse bëri një kërkesë demokratike ndaj shtetit maqedon.

Ai bëri të ditur se "Partia opozitare shqiptare, Aleanca për Shqiptarët do ta mbështesë referendumin që do të mbahet më 30 shtator, por kërkoi që faktori politik shqiptar dhe maqedonas të nënshkruajnë marrëveshje brendashtetërore që të arrihet barazia etnike dhe në kuadër të ndryshimeve kushtetuese të futet gjuha shqipe si zyrtare".

Sela foli për avancimin e statusit të shqiptarëve në Maqedoni, një kërkesë e natyrshme që tek e fundit shoqëron çdo fushatë për referendum apo zgjedhje politike, por që bie ndesh me konceptin sllavo-maqedon për t'i mbajtur shqiptarët me një status të ulët dhe diskriminues.

Kërcënimi ndaj Selës është i patolerueshëm dhe me shumë pasoja për të ardhmen e shtetit maqedon, pasi kjo frymë urrejtjeje mund të çonte në ndarje të vendit, për shkak se shqiptarët në Maqedoni, nuk do të lejojnë kurrë më që t'u vihen në pikëpyetje të drejtat e fituara. Shqiptarët në këtë shtet janë duke kërkuar një perspektivë të qartë euroatlantike, dhe siguri që nuk do të përndiqen për idetë e tyre demokratike, përkatësinë etnike dhe gjuhën. Për ndryshe shqiptarëve do t'u duhet të kërkojnë të ardhme tjetër.

Pas dështimit të referendumit të qeverisë, shqiptarët etnikë në Maqedoni do të duhet të mbanin një referendum ku të shprehnin dëshirën e tyre se në cilin shtet dëshirojnë të jetojnë, në atë gjysmë Maqedoni, apo në një shtet të integruar në NATO si Shqipëria dhe me perspektivë të qartë për t'u anëtarësuar në BE.

Nëse sllovo-maqedonasit duan ta shkatërrojnë Maqedoninë, ta bashkojnë me Bullgarinë apo ta bëjnë vend satelit të Rusisë, shqiptarët nuk kanë pse e pengojnë, por të shohin interesat e tyre kombëtare euroatlantike.

Acarimi i situatës në Maqedoni, do të zgjonte një valë protestash të shqiptarëve në Luginën e Preshevës, të cilët e kanë shprehur hapur dëshirën e tyre për t'u bashkuar me Kosovën, por do të rikthente në axhendën e politikës edhe të drejtat kombëtare të shqiptarëve etnikë në Mal të Zi.

Nga këto lëvizje të imponuara, ku shqiptarët në rajon do të ishin të kërcënuar, Shqipëria si vend anëtar i NATO-s, do t'u dilte hapur në mbrojtje, duke implikuar direkt Aleancën e Atlantikut të Veriut.

Tani në pyetje është nëse shqiptarët duhet ta shpejtojnë përsëri Maqedoninë me 30 shtator, apo jo?

Shqiptarët në Ballkan, nuk duhet të pranojnë asnjë marrëveshje që kërcënon sigurinë dhe të ardhmen e tyre dhe për këtë duhet të ushtrojnë presion ndaj elitave të tyre politike në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Podgoricë, Luginën e Preshevës etj.

Shqiptarët kanë bërë marrëveshje me Greqinë dhe nuk i kanë vendosur asnjë kusht reciprok asaj, ndërsa Athina për çdo ndihmë që i ka dhënë Tiranës për çështje të integrimit euroatlantik, i ka vënë Shqipërisë kushte diskriminuese, biles poshtëruese.

Shqiptarët kanë bërë dhe po bëjnë marrëveshje me Serbinë dhe Prishtina nuk i vendos asnjë parakusht Beogradit, të paktën siç e do edhe praktika e partneritet reciprok ndërkombëtar, për të dëshmuar se po negociojnë dy shtete sovrane. Kjo ka patur për pasojë atë që Serbia i ka fituar të gjitha dhe është në paradhomën e BE-së dhe Kosova absolutisht asgjë. Biles tani, në përmbyllje të këtyre bisedimeve, Kosova po humbet edhe legjitimitetin ndërkombëtar dhe sovranitetin e njohur nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe nga 116 shtete te botës, për t'i hequr pengesën e fundit dhe hapur autostradën Beogradit për në BE.

Shqiptarët etnikë në Maqedoni kanë qenë në kushte më të pafavorshme dhe të vështira. Të paktën gjatë dy dekadave të fundit Shqipëria ka treguar pak vëmendje ndaj avancimit të statusit të tyre atje, ndërsa Kosova e gjendur në kriza të panevojshme dhe të çuditshme, të brendshme, nuk ka treguar interes për shqiptarët në Maqedoni.

Kështu që duke e përjashtuar rastin e unifikimit të qëndrimeve për largimin e ish-kryeministrit autoritarist Gruevski nga pushteti, nuk kanë treguar se mund të bashkëpunojnë për gjëra me interes kombëtar.

Tani është një tjetër rast që duhet ta bashkojë përsëri faktorin politik shqiptar në Maqedoni.

Siç jemi duke e parë, deri tani, shqiptarët po shkojnë në një referendum për emrin e ri të Maqedonisë pa i vënë asnjë kusht qeverisë së Maqedonisë për të avancuar statusin e tyre, ta zëmë sa komunat e vogla serbe në veri të lumit Iber.

Kjo është një dobësi e elitave politike në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup, të cilat nuk duket se janë në gjendje të menaxhojnë edhe situatën që do të vinte në rast të dështimit të referendumit.

Pas arritjes së një marrëveshje me qeverinë maqedonase lidhur me futjen e gjuhës shqipe në Kushtetutën e re si gjuhë zyrtare, krahas emrit te ri te vendit, pjesëmarrja e shqiptarëve në referendum nga pikëpamja ndërkombëtare do të kishte disa anë pozitive.

Së pari, dëshmojmë se jemi një komb me orientim proatlantik aty ku jemi në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi apo në Luginën e Preshevës.

Në fakt, shqiptarët treguan këtë përcaktim euroatlantik tani së fundi edhe në Mal të Zi, duke qenë përcaktues për fitoren e qeverisë properëndimore në Podgoricës dhe për interesimin e Malit të Zi në NATO.

Ndërkohë që pakicat serbe në këtë shtet e kundërshtuan me të gjitha mjetet orientimin e ri të shtetit të vogël malazez.

Së dyti, dëshmojmë se nuk ishin shqiptarët shkatërruesit e Maqedonisë, por vetë sllavo-maqedonasit.

Së treti, SHBA-të, e mbështesin referendumin dhe ne duhet të jemi në të njëjtën valë me aleatët tanë perëndimorë.

Së katërti, tek e fundit një shtet i anëtarësuar në NATO apo edhe në perspektivë për t'u anëtarësuar në BE është më i prirur të sigurojë të drejtat kombëtare dhe të drejtat themelore të shqiptarëve. Shtetet demokratike e ruajnë si arsye të fundme luftën.

Ka plot shqiptarë në Tiranë, në Prishtinë apo edhe në Shkup që thonë se për çdo gjë duhet të presim sa të forcohet Shqipëria, Kosova e kështu me radhë dhe pastaj të shtrojmë çështjet tona.

Po të kishte pritur kështu UÇK, Kosova akoma do të ishte nën Serbi.

Tek e fundit shqiptarët në Maqedoni janë duke kërkuar demokraci dhe demokracia nuk pret, të drejtat kombëtare nuk presin, liritë themelore dhe perspektivat euroatlantike nuk presin, prandaj këshilla ma e mirë do të ishte që faktori politik shqiptar në Maqedoni të mbante një konference tjetër, ku të koordinoheshin mirë qëndrimet e tyre jo vetëm për referendumin për emrin, por edhe pas këtij referendumi në raport me zhvillimet në rajon dhe në botë.

Konferenca do të kishte si qellim të përcaktonte kushtet e tyre ndaj qeverisë maqedonase, meqenëse do të ketë ndryshime kushtetuese për emrin e ri të Maqedonisë të përfshihet në Kushtetutë edhe njohja e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në këtë shtet.

***Drejtor i gazetës "Nacional"**

Dje në "Zërin e Amerikës"

# Letër lamtumire

Nga John McCain

*(vijon nga faqja 1)*

... u largova nga jeta si një amerikan krenar"-shkruan McCain.

"Ne e dobësojmë madhështinë tonë kur ngatërrojmë patriotizmin tonë me rivalitetet klanore që kanë mbjellë armiqësi, urrejtje dhe dhunë në të gjitha anët e globit. Ne e dobësojmë atë kur fshihemi prapa mureve, në vend që t'i rrëzojmë ato, kur dyshojmë në fuqinë e idealeve tona, në vend që t'u besojmë atyre si forcë e madhe për ndryshim, ashtu siç kanë qenë gjithmonë"-thuhet në letër.

"Ne jemi treqind e njëzet e pesë milionë individë, secili me mendimin e vet dhe që debatojmë zhurmshëm. Ne zihemi dhe konkurrojmë madje nganjëherë fyejmë njëri-tjetrin në debatet tona të ashpra publike. Por gjithnjë kemi pasur shumë më tepër gjëra të përbashkëta me njëri-tjetrin sesa mosmarrëveshje. Nëse e ngulisim këtë në mendje dhe i japim njëri-tjetrit të kuptojë se ne të gjithë e duam vendin tonë, atëherë do të arrijmë t'i kapërcejmë këto momente sfidash dhe do të dalim prej tyre më të fortë se më parë, ashtu si gjithmonë."

"Mos e humbni shpresën nga vështirësitë e tanishme, por besoni gjithmonë në premtimin dhe madhështinë e Amerikës, sepse këtu asgjë nuk është e pashmangshme. Amerikanët kurrë nuk largohen nga gara. Ne kurrë nuk dorëzohemi. Kurrë nuk i fshihemi historisë. Ne bëjmë histori."

"Lamtumirë, vëllezër amerikanë. Zoti ju bekoftë dhe Zoti e bekoftë Amerikën", përfundon letra e Senatorit McCain.

## FLAMURI MBI SHTËPINË E BARDHË

Flamuri mbi Shtëpinë e Bardhë, i cili u ul gjatë fundjavës në gjysmë shtizë si shenjë respekti për senatorin John McCain, u ngrit përsëri i plotë, por të hënën pasdite u ul përsëri.

Ngritja e flamurit mbi Shtëpinë e Bardhë u prit me kritika nga e majta dhe e djathta, duke përfshirë organizatën e veteranëve American Legion.

Ndërkohë, flamuri në selinë e Kongresit vazhdon të jetë në gjysmë shtizë për nder të senatorit të Arizonës.

Presidenti Donald Trump ka shprehur ngushëllimet e tij në 'Twitter' për familjen e senatorit McCain, por deri të hënën pasdite nuk kishte lëshuar një proklamatë për nder të tij.

Të hënën pasdite ai lëshoi një deklaratë ku thoshte: "Me gjithë mosmarrëveshjet tona politike, unë e respektoj shërbimin që Senatori John McCain i ka bërë vendit dhe për nder të tij kam nënshkruar një proklamatë për të ulur flamurin amerikan në gjysmë shtize deri në varrimin e tij. I kam kërkuar nënpresidentit Mike Pence të mbajë një fjalim në ceremoninë për nder të senatorit McCain në ndërtesën e Kapitolit të premten".



Presidenti Trump dhe Senatori McCain kanë shkëmbyer prej kohe kritika mes tyre.

Kodi i Flamurit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës kërkon që flamujt të ulen "në ditën e vdekjes dhe të nesërmen e asaj dite për një anëtar të Kongresit."

Megjithatë, sipas një tradite të hershme, për njerëzit me kontribut të shquar për vendin, flamuri qëndron i ulur deri në varrimin e tyre.

Në vitin 2009, pas vdekjes së Senatorit demokrat Ted Kennedy, Presidenti Barak Obama urdhëroi uljen në gjysmë shtize të flamujve në ndërtesat qeveritare, të cilët qëndruan ulur për disa ditë.

Presidenti Trump nuk iu përgjigj gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë kur u pyet nëse e konsideronte senatorin e ndjerë një hero.

## CEREMONI NË ARIZONA DHE UASHINGTON

Senatori John McCain, i cili vdiq të shtunën pas një beteje të gjatë me kancerin e trurit, do të nderohet me ceremoni në Arizona dhe Uashington.

Trupi i tij do të vendoset së pari, në Kapitolin e shtetit të Arizonës, ku të mërkurën do të mbahet një ceremoni private, me rastin e 82-vjetorit të ditëlindjes.

Të enjten, në një kishë baptiste të qytetit Feniks do të mbahet një shërbim përkujtimor privat me pjesëmarrjen e publikut.

Në Uashington, ku flamujt në institucionet e ndryshme janë ngritur në gjysmë shtizë, trupi i senatorit McCain do të vendoset të premten në ndërtesën e Kapitolit, ku njerëzit do të bëjnë homazhe.

McCain do të jetë senatori i 13-të amerikan, trupi i të cilit nderohet në sallën rrethore të Kapitolit, një nder që u rezervohet "qytetarëve më të shquar" të vendit, si pas zyrtarëve të Kapitolit.

Të shtunën në Katedralen Kombëtare të Uashingtonit do të mbahet një shërbim përkujtimor, ku do të flasin ish-presidentët Barak Obama dhe Xhorxh W. Bush.

Senatori McCain do të prehet në Varrezat e Akademisë Detare në Anapolis të shtetit Marilend, pranë mikut më të ngushtë që ai kishte gjatë viteve të Akademisë Detare, Admiralit Chuck Larson.

## HOROSKOPI

### DASHI

Do të përjetoni një keqkuptim me një mikun/miken tuaj, çfarë do t'ju shkaktojë pakënaqësi. Përpiquni të mendoni në mënyrë të ekuilibruar, që të mos gjykoni në mënyrë të gabuar.

### DEMI

Ka gjasa të tensionoheni për shkak të punës. Përpiquni t'i shmangni personat që iu afrohen vetëm për interes. Shmangia e përgjegjësive familjare mund të irritojë të afërmit tuaj. Partneri/partnerja juaj mund t'ju kërkojë të ndërmerrni një vendim shumë të vështirë sot.

### BINJAKET

Bamirësia që do të bëni sot do t'ju sjellë paqe dhe rehati. Investimet në sendet antike dhe në bizhuteri do t'ju sjellin plot fitime. Familjarët tuaj do të tregohen më mbështetës seç mund ta kishit menduar ndaj disa nevojave tuaja.

### GAFORJA

Vullneti juaj mund të shpërblehet sot, pasi do të përballeni me një situatë shumë të vështirë. Mos e humbisni durimin, teksa duhet të merrni një vendim të rëndësishëm. Nëse keni ndërmend të investoni diku, duhet të bëni shumë kujdes. Një miqësi e ngushtë ka gjasa të kthehet në dashuri.

### LUANI

Duhet të bëni disa ditë pushime, në mënyrë që t'i largoheni agjendës suaj monotone. Mos bëni plane, të cilat nuk mund t'i realizoni. Jeta juaj martesore mund t'ju duket paksa e mërzitshme këto ditë, ndaj duhet të mendoni mënyra për ta bërë atë sa më interesante.

### VIRGJERESHA

Disa ndryshime që do të bëni sot në lookun tuaj do t'ju bëjnë të ndiheni më mirë. Mos i kushtoni rëndësi fjalëve të të tjerëve, pasi kjo mund t'ju sjellë vetëm humbje. Sa i përket anës romantike, do të jetë dita juaj me fat.

### PESHORJA

Përpiquni ta kontrolloni veten, pasi kjo mund të shkatërrojë marrëdhëniet me personat përreth jush. Këtë mund ta arrini duke u treguar më mendjehapur dhe duke mos i paragjykuar të tjerët. Ka gjasa që sot të keni ide të reja, të cilat do t'ju sjellin fitime.

### AKREPI

Mos e humbni qetësinë, pasi kjo mund t'ju shkaktojë probleme të mëdha në familjen tuaj. Nëse ruani kontrollin do të jeni në harmoni. Përpiquni të kryeni disa aktivitete, të cilat mund t'ju largojnë stresin dhe lodhjen.

### SHIGJETARI

Mos hezitoni të shprehni pikëpamjet tuaja. Mos e humbisni besimin në vetvete, sepse do të ndikojë negativisht në progresin tuaj. Bëni kujdes, pasi dikush mund të përpiqet t'ju shkatërrojë imazhin.

### BRICJAPI

Mos lejoni që disa detaje të vogla t'ju shqetësojnë. Ka gjasa që sot të mos kaloni një ditë shumë të këndshme në çift, për shkak të disa problemeve që do të irritojnë partnerin/partneren tuaj. Përpiquni t'i kushtoni kohën e duhur familjes.

### UJORI

Përpiquni të mos tregoni rreth investimeve dhe qëllimeve për të ardhmen tuaj. Do të kaloni një ditë shumë të bukur në çift, ndërsa sa i përket planeve për të udhëtuar, do të bëni disa ndryshime në momentin e fundit.

### PESHQIT

Përpiquni të relaksoheni pas pune dhe shmangni eventet në orët e vona. Mos i kushtoni rëndësi thashethemeve, pasi mund të përfshiheni në një konflikt të madh. Veproni me kujdes në mënyrë që ta zgjidhni situatën sa më lehtë.

# INTERVISTA
## SPECIALE (PJESA E DYTË)

Intervista / Dëshmia e rrallë e 98-vjeçares Marte Biba Doçi, e motra e "Heroit të Popullit", Bardhok Biba

# Motra e Bardhok Bibës: S' pranova të firmosja "që isha e dalë mëndsh" dhe shkova në burg

*"Pasi dola më internuan në Seman ku kisha familjen. Aty më dënuan me burg edhe dy djemtë, Markun e Pashkun"*



Djemtë e Marta Bibës (nipat e Bardhok Bibes)

Nga Dashnor Kaloçi

Duke qenë një familje dëshmori, apo si motra e "Heroit të Popullit", Bardhok Biba, mund dhe do të kishte përfituar shumë nga ai regjim, si shumë familje të tjera kudo nëpër Shqipëri dhe më e pakta do kishte kaluar një jetë të paqtë pa shumë andralla. Madje jo vetëm kaq, por po t'i kishte bërë sadopak "duva" atij pushteti, do kishte përfituar shumë e shumë lavdi e privilegje, po të kemi parasysh edhe faktin se; personalisht Enver Hoxha do të shkonte disa herë për vizitë në shtëpinë e Bardhok Bibës në Rrëshen, do të çonte djalin e tij me nusen (Ilirin me Teutën) te dasma e Marie Bibës, (madje edhe me dhurata), të cilën e ftonte edhe në Tiranë në raste festash, përvjetorësh, apo Kongrese, si p.sh. në Kongresin e 8-të të PPSH-së, ku në Pallatin e Brigadave, vetë Enveri do t'ia merrte valles me Marien, duke iu thënë me mburrje delegatëve të tjerë: "E kam vajzën e shokut tim të Luftës"?! Gjëra të cilat "shoku Enver", nuk i kishte bërë kurrë me asnjë prej figurave kryesore të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, dhe emblematike të propagandës e historiografisë së regjimit komunist, si p.sh. Qemal Stafa, Vojo Kushi, Vasil Shanto, Misto Mame, Alqi Kondi, Vasil Laçi etj. etj., shokë e bashkëpunëtorë të afërt të tij që i kishin familjet në Tiranë?! Por Marte Biba Doçi duket se as ka dashur t'ia dijë fare për këto gjëra dhe me vetëdije të plotë ajo dhe familja e saj nuk pranoi asgjë nga ai pushtet, asnjë nga privilegjet që u bëheshin familjeve të dëshmorëve, apo e Heronjve të Popullit, siç ishte i vëllai i saj, Bardhok Biba?!



Gazetari Dashnor Kaloçi me motrën e Bardhok Bibës, Marte Biba Doçi

Madje ajo zgjodhi të kundërtën, duke e kundërshtuar politikën e atij regjimi bash në një nga pikat kryesore të reformave me të cilën mburrej ai regjim, te "kolektivizimi i fshatarësisë", pasi Martja me familje e saj nuk pranuan kurrë që të hynin në kooperativë. Gjë për të cilën do të kishin pasoja të rënda, duke përfunduar familjarisht burgjeve dhe internimeve të atij regjimi për vite me radhë. Dhe si për t'i qëndruar konsekuente deri në fund bindjeve dhe traditës së familjes të saj, ashtu siç i takonte një "bijë që rridhte nga familja e Kapidanit të Mirditës, Gjon Markagjonit", Martja shkoi e vetëdijshme në burg, duke mos pranuar të firmoste në gjyq një dokument ku thuhej se "ishte e dalme mëndsh", gjë e cila nuk qëndronte dhe ishte një kompromis që pushteti i asaj kohe kërkonte ta bënte jo për të shpëtuar Marten, por për veten, që të mos diskreditohej nga "njerëzit e vet", siç konsiderohej dhe ishte familja e Bardhok Bibës. Lidhur me këto dhe të tjera ngjarje dhe fakte nga jeta e saj, 98-vjeçarja Marte Biba Doçi me një memorie brilante dhe shëndet fizik si jo më mirë, na i rrëfen për herë të parë dhe ekskluzivisht për "Gazeta Shqiptare", intervistë të cilën po e publikojmë pa i ndryshuar asgjë dhe, gjithashtu, në dialektin e saj.

**A e kujton gjyqin tuaj?**

Pooo posi s'e kujtoj. Mbas një jave që ndodhi kjo ngjarje më çuan në birucat e Krujës. Atje kam ndenjur, nga një shtatori dhe deri më 1 Maj, kam ndenjur në birucat e Krujës.

Gjygjin me kallxu drejt, s'e kush qe ai (e ka fjalën për Kryetarin e Gjyqit, shënimi ynë. D.K.), un s'e di, unë e mbaj mënd fjalën, thaaa, qe besa e zotit pa rrena, tha; lësho firmë këtu, tha, se jam prish mëndsh…..! Jo i thash, për shpirtin e Bardhok Bibës dhe të Marka Bibës, nuk e bëj atë gjë.

Isha një grua e pashkollë, një grua me një fëmij të vogël, një grua eee, pa trazuar asnjeri, në hesapin tim, në punën time….

**Pra, ju kërkuan që ju të firmosnit një dokument që ishit me probleme…?**

Pooo kështu m'tha, hec lësho firmën më thanë, në Krujë. Një djal i ri ishte, një djal i ri, që më thërriti. Më tha më lësho firmë se kam dal mëndsh, jo përzotin i thash, ç'farë se kam, s'mundem ta bëj. Ishim pa faj, ishim pa faj, qe besa e zotit dhe për shpirtin e Bardhok Bibës kështu…nuk firmosa asgjë.

**A u përmend aty në gjyq, fakti se ju ishit motra e Bardhok Bibës?**

Pooo, një djal i ri, tha; shikoni kë keni para, motrën e Heroit, Bardhok Bibës…!

**Para se të fliste ai, po ju vetë nuk thatë në gjyq se ishit e motra e Bardhok Bibës?**

Nuk e thashë… se jam motra e Bardhok Bibës, se atë gjë e kishte marrë vesht Tirana, Shkodra, Durrësi…ça të thosha unë, atë e dinin të gjithë gjykatës, prokuror e polici, si nuk e dinin?!

**Si u mbrojtët ju në gjyq lidhur me atë ngjarje për të cilën dhe ju kishin arrestuar?**

Thashë më kanë trishtuar në familje, thashë kam pas një fëmijë të vogël, e kanë gjet përmbys, vdiq se s'kishte kush me e kthye për së mari, thashë jeni rrotulluar aty nëpër shtëpi, më keni kap me dorë…!

**Çfarë ju thanë ata?**

Kur më dënuan, (më tha mua ai, po nuk e mbaj mënd, një djal i ri), më tha; thuaj kam dal mëndsh, qenë duke më liru, thashë s'mundem ta bëj atë, s'mundem e bëj u thashë….

Ishin duke e parë se ishim e pafajëshme, se kishin ardh në familjen time dhe më trishtuan, thuaj kam dal mëndsh…, s'e pranoj, u thashë……

**Pra, ju kërkonit që të firmosnit një dokument ku ju të pranonit se ishit e papërgjegjshme nga ana mendore dhe pas kësaj t'ju lironin duke ju nxjerrë të pafajshme?**

Poooo, këtë më kërkojshin, por unë nuk pranojsha. Për kryet e Bardhok Bibës dhe për kryet e katër djemve, kështu thash unë, s'mund e bëjë atë. Qenë duke më lirue, si të pafajëshme, më kishin trishtu në familje, por unë nuk pranova me firmos se jam e dalme mëndsh, se nuk isha. Isha në punë time, ata erdhën dhe më tanun… (trazuan).

**Pasi nuk pranuat të firmosnit atë që ju kërkonin ata, ju dënuan?**

Po më dënuan. Kam hyrë më 1 apo më 2 shtator, nuk e di, në biruca të Krujës, dhe kam dal për Nji Majin. Kur më kanë shti në burg më kanë çu e nxjerrë në Tiranë me më bashku me të tjerët, se ishin dhe të tjerët aty për në burg, se ishte makina me shku në Qytetin Stalin.

**Para se të na flisni për vuajtjen e dënimit në burgun e Qytetit Stalin, na thuaj, po me familjen tuaj, djemtë dhe burrin tuaj, çfarë ndodhi. A patën pasoja ata pas kësaj ngjarje që ju u përleshët fizikisht me kryetarin e këshillit dhe shefin e policisë së Laçit?**

Posi nuk patën, patën posi. Burrin e tre djemtë m'i murrën dhe i internuan anej ka Myzeqeja, në Seman i thoshin ku kishte plot familje të tjera të prekura si u thoshin at'herë. Murrën dhe familjen e kunatit tim, (vëllajt të burrit) dhe atë atje në Seman me ne. Vetëm këtë djalin, Valentinin, këtë s'e murrën, ishte i vogël ky atëhere, nja 13-14 vjeç dhe nuk e lejote ligji me e marr n'internim. Kshtu na thanë dhe ky meti ktu me kunatën time.

**Tani të flasim pak për dënimin tuaj. Si i e kujton periudhën e burgut në Qytetin Stalin, sa kohë qëndruat atje dhe si silleshin me ju policët e drejtoria e atij burgu?**

Në Qytetin Stalin më kanë lënë nji vjet gati, por ata oficerët të mirë, ishin të mirë, as më thoshin bëje normën, pse s'e ke bërë, Më






thoshin gardianet, aman kokëzëzën..., se ishim me shami të zezë, bëshin llafe ato, ma kini kujdes, se vijshin të rij e nuk më njifshin...

**A kujton ndonjë nga bashkëvuajtëset tuaja në atë burg?**

Poooo, posi. Ishin dy polake, dy nga Polonia, U vinin ushqimet nga Polonia, ato më thërritnin për kafe, ato ishin zonja të rënda. Dhe kur u lirova, më dhanë dy fustane për nusen e djalit, nusen e këtij, (tregon me dorë djalin, Markun. Shënimi ynë, D.K.), m'i mbajti Dega, nuk është e lejueshme. Ishin copa të mira. Laj e thaj, s'kishin nevoj për hekur. Ato kishin burrat në burg. Barbara Mullahi, Barbara Orgocka. (Barbara Orgocka, bashkëshortja e Vaskë Orgockës, nga Korça, vëllait të aktorit të famshëm Dhimitër Orgocka. Shënimi ynë, D.K.). Ato kur bënin ndonjë ëmbëlsirë dhe ndonjë gjë, patjetër dilnin në penxhere dhe ...Marta..., më thërritshin, hajde shpejt këtu me ne...dhe e ndanin me mua kafshatën e gojës.

**Si e kujtoni lirimin tuaj nga burgu?**

E kujtoj shumë mirë. Kur dola nga burgu aty në Qytetin Stalin, u thashë atyre gardianeve; ju falenderoj...., se nuk ishin sjellë keq me mua. Se unë rrinja e fundit për ushqimin, jo me u turr (nxitu), me të rinj e të vjetër, as te kazani (guzhina) as kund, jo....

**Pasi ju liruan nga burgu, ku ju çuan?**

Më çuan në Fermën e Semanit....n'internim, atje ku ju thashë se më kishin çu burrin me djemt dhe familjen e kunatit.

**Si e kujtoni periudhën e internimit, si silleshin me ju dhe familjen tuaj ata të policisë apo të tjerë...?**

Keq shumë keq janë sjellë me ne. Mozo ma keq...atje ma dënun dhe ma futën në burg, edhe këtë djalin e madh Markun dhe djalin tjetër, Pashkun. Të dy në burg. Mos e pyt se çfar kanë ba ndër ne, krejt kot, pa ba gja....

**Po pse e dënuan Markun dhe Pashkun me burg, çfarë bënë ata...?**



Njëherë, ky djali (Valentini), ishte i vogël, nëntë vjeç, dhjetë vjeç, mori dy gjingja ktu ke shpija në Laç e na i solli ne atje për Vit të Ri atje n'internim. Ky djali i madh, (Marku), erdhi prej punës dhe një oficer policie..., (ja harroj emrin atij oficerit), ...tha: nuk kini për t'i marrë gjingjat. Marku i tha do t'i marrim se janë tonat. Bre po, bre jo, dhe i nxorri revolen këtij, (Markut), e paska pas mësimore, me leje, dhe ja nxorri afër kokës, dhe u step...

**Si reagoi Marku?**

Marku i tha; dhe këtu jam duke u bë ndonjë gjë, ndonjë kundërshtim, u tha Marku, m'u hiqni qafe për hatrin e zotit, jam më nënën dhe me babë, e më vëllazën të dy....,

-Hajt i tha ai, i plotfuqishmi i ligjeve, edhe e morri ky burri im këtë qingjin dhe e largoj e ku e di unë...,

**Po i plotfuqishmi...?**

Ai i plotfuqishmi ju hodh këtij (djalit, Markut) në fytyrë...dhe ky i tha: m'u largo, dy duar për një kokë janë, i tha, dhe ai i plotëfuqishmi gjuajti me revole përmbi kokë, bam, gjuajti...

-M'ë vrave djalin, u thashë, edhe këtu u kam borxh, edhe këtu m'ë trishtoni në familje, më vratë djalin more, edhe u mblodhën, po u mblodhën aty njerëz edhe se çfarë u bë nuk e di dhe e morrën.

**Ku i çuan...?**

I thanë: përpara dhe e vunë në një zetor, edhe burrin edhe Pashkun, edhe i çun në polici, në Dëgë të Mbrendshme. Burrin, (Prengën) e lshune dhe erdh prap n'internim në Seman, ndërsa Markun e majtën 16 ditë aty dhe ma vonë e dënun 3 vjet burg dhe e dërgun në Ballsh, në burg të Ballshit.

**Po djalin tjetër, Pashkun përse e dënuan....?!**

Pashkut i thotë një grue..., ishte spiune këtu, ishte ngjit me të, Naimja, ...Ishte duke e prit me një me biçikletë...., hajde zëmë peshk...,

-I thashë; Pashk, qe besa e zotit mos shko, se të kapën, i thashë. Qe besa e zotit mos shko se të kapën, a e shef si janë i thashë, të gjithë spiunët rreth....!

Tha; jo do të shkoj për peshk dhe shkoj dhe e kapën dhe atë mbrenda. E dënuan tre vjet burg Pashkun, se gjoja kishte kalu zonën ku u lejote me shku të internumit. Pra sikur kishte kalua kufirin...?!

**Sa vjet qëndruat ju dhe familja juaj në internim?**

Nja shtatë vjet qe besa atje në internim. Shtatë vjet plot (1970-1977, Shënimi ynë. D.K.)

**Po pas daljes nga burgu dhe lirimit nga internimi, ku ju çuan?**

Edhëm këtu te kunata, (në Laç), shpija shkatërrue, shkatërrue, çdo gja. Ajo kishte gjashtë fëmijë dhe kunatin shtatë, e shkreta në kooperativë, në fermë, e shkreta se ka pas qenë nda me atë djalin e erdh te na. Ajo më është gjetur më tepër se nana, se kur ishim në burg, ajo i lante rrobat e shkreta, 90-vjeçe, vinin mecat (djemtë) nganjerë në Qytet Stalin, përzotin kemi vujt, për kot...

**Po pas kthimit nga internimi dhe nga burgjet, ku punuan djemtë tuaj, a u futët në kooperativë?**

Mbasi erdhëm nga internimi, na lanë dhe nja dy vjet pa punë. Vumë do bagti ashtue dhe u morrëm me to mbrapa, dhe e panë se ishim duke u kap me to (gjoja pasuruar, Shënimi ynë, D.K.) dhe na thirrën në Degë të Brendëshme atje n'Krujë, ishin mbledh Kryetar Dege atje, ishin mbledh..., ka qenë një tropojan i madh Kryetar Gjykate, me Zef Dedën, Zef Deda dhe ai, Qazim Mani, m'duket, ishin ata, erdhën për me na fut në kooperativë dhe s'u futëm. I thashë; o ku kam qenë në internim, o në burg, o na pushkatoni, se në kooperativë nuk futemi. Dhe nuk u futëm asnjë ditë. Na ka pas ardhe dhe Rrem Sefa ma na fut në kooperativë, por s'kena pranue. Jooo, asnjë ditë nuk kena pranu me hi në kooperativë, asnjë dit. Ne prandaj u dënuam mos me hi në kooperativë. Nuk kena pranu dhe ata të partis e shtetit janë detyru me na shti në pun në fermë, andej ka Fush-Kuqja kan punu djemt në fermë. Ishin të zot dhe të fortë dhe kan punu shum, të katër djemtë në fermë kanë punu.

**Para se të dënoheshit në burgje dhe internime, a ju vinin këta të Partisë dhe të Shtetit për vizitë për 5 Majin, si familje dëshmori?**

Jo nuk na vinin, vetëm me na fut në kooperativë, jooo, dhe pse isha e motra e Bardhok Bibës, jooo, mos ta dëgjoj kush, jooo nuk vijshin, një grua e pashkollë, një grue me katër fëmijë, e m'i nxorrën nga shkolla, e m'i nternuan, e m' trishtuen boll, se ishim një grua që nuk kishim pranue me u fut në kooperativë,. Drejt, ishim një grue që nuk kisha pranue me u fut në kooperativë dhe nuk më erdhën asnjëherë, dhe unë bëra timen.

**Për të gjitha këto që ju ndodhën atëherë, a je ankuar, apo a ke shkruar ndonjë letër, p.sh. Mehmet Shehut, që thuhet se e ka dashur shumë vëllanë tuaj, Bardhokun?**

Joooo, nuk kam shkruj letra Mehmet Shehut, se e dinte ai se isha e motra e Bardhok Bibës..., edhe pse kishte edhe punët e shteteve të tjera. E dinte asi, por unë nuk i kam shkrujt letra kurrë...

**Po atë pushtet, pra regjimin komunist, e donit ju....?**

Kur kishim Bardhokun gjallë e dojshim, e dojshim sa ishte Bardhoku gjallë, por më pas ...isha e ftohur në mish e në shpirt..., nuk e kam dasht hiç.

**Tani pas viteve '90-të, a keni përfituar ndonjë dëmshpërblim financiar, për vitet e burgut dhe internimit që keni bërë ju dhe djemtë tuaj?**

Jooo, asgjë nuk kena marrë. Nuk ju takon na kanë thënë...,s'keni qenë për politikë...?! Po ça politike dun ata....ne kemi kundërshtu shtetin mos me hi në kooperativë. Po, jo na kanë thënë; s'ju takon dhe kështu asgjë nuk kena marrë....?!


Enver Hoxha, Beqir Balluku dhe Medar Shtylla së bashku me prindërit e Bardhok-Bibës pas vrasjes së tij në-Mirditë.1949

### Florida, shpëton për mrekulli shqiptari 19-vjeçar nga të shtënat

# Masakra në SHBA, identifikohet autori që u mori jetën dy personave e plagosi 19 të tjerë

Pasi mori pjesë në një turne videolojërash në Jacksonville, Florida, një person ka qëlluar për vdekje dy persona para se të vriste veten ditën e djeshme, sipas BBC. Vrasësi është identifikuar si David Katz, 24 nga Baltimore dhe thuhet se ai përdori një pistoletë të thjeshtë ndërkohë që s'ka të tjerë të dyshuar. 19 persona të tjerë u plagosën të dielën në Jacksonville Landing, një kompleks i madh tregtar dhe ambient argëtimi. Sipas disa njoftimeve të pakonfirmuara, Katz u zemërua pasi humbi në eventin e sportit amerikan eSports. Emrat e viktimave s'janë bërë ende publik derisa të afërmit e tyre të informohen. Gjatë viteve të fundit, Florida është goditur nga disa vrasje masive, duke përfshirë lokalin e natës Pulse në Orlando, në vitin 2016, kur vdiqën 49 persona dhe në Shkollën Marjory Stoneman Douglas në Parkland në shkurt të këtij viti, kur 17 persona mbetën të vrarë. Një shqiptar u ka shpëtuar për mrekulli të shtënave me armë zjarri. Drini Gjoka, një lojtar 19-vjeçar, ka përshkruar të shtënat në një seri postimesh në Twitter, duke e quajtur atë si dita më e keqe e jetës së tij. Ai shkroi se një fishek e kishte prekur atë në gishtin e madh të dorës. "Unë jam me shumë fat. Fisheku më preku në gishtin e madh të dorës",-shkruan ai në Twitter. Një tjetër konkurrent tha se një plumb i kishte shkaktuar një plagë të lehtë në kokë. Njerëzit u larguan të tmerruar kur të shtënat nisën dhe policia iu bëri thirrje të ruanin qetësinë ndërsa zona po kontrollohej për bashkëpunëtorë të mundshëm para se të konfirmohej që autori kishte vepruar i vetëm.

**SHQIPTARI QË SHPËTOI SHKRUAN NË TWITTER:**
"Kjo është dita më e keqe e jetës sime. Unë jam me shumë fat. Fisheku më preku në gishtin e madh të dorës",-shkruan shqiptari në Twitter, i cili shpëtoi nga masakra në Florida ditën e diel në një turne video-lojërash.


Pamje nga vendi i masakrës në Florida

### "Duhen bërë marrëveshje me shqiptarët", deklarata që nxiti mllef ndaj kreut të ASH

# Kërcënohet me jetë Ziadin Sela, "Luanët" maqedonas e pranojnë

## Vijon sulmi pas 27 prillit: Kireja duhej t'ia këpuste kokën

Ditën e djeshme, kreu i Aleancës për Shqiptarët në Maqedoni, Ziadin Sela, është kërcënuar me jetë në rrjetet sociale nga huliganët maqedonas. Kërcënimi ka ardhur pak orë pas deklarimit të tij para dy ditësh se përpara ndryshimeve kushtetuese, duhet bërë një marrëveshje përfundimtare mes maqedonasve dhe shqiptarëve në mënyrë që njëherë e përgjithmonë t'u jepet fund konflikteve të brendshme midis qytetarëve në Republikën e Maqedonisë. Në një postim të grupit të deklaruar si "Luanët Maqedonas", në mënyrë të hapur shprehet mllefi i tyre ndaj kërkesës së Ziadin Selës, duke deklaruar se gjatë 27 prillit të përgjakshëm, ai ka kaluar shumë lehtë dhe se është dashur "Kireja t'ia këpusë kokën." Nga ASH thonë se me këtë deklaratë, përveç që publikisht shprehet mllefi ndaj kërkesës natyrale të kryetarit të Aleancës, Ziadin Selës, publikisht pranohet se Kire Georgievski, i cili u fotografua duke qarë gjatë gjykimit të 27 prillit dhe në të cilën mbrohej se ka ndihmuar Ziadin Selën, e ka kryer pikërisht atë për të cilën edhe është dënuar. "Si duket Ziadin Sela vazhdon të jetë target i huliganëve maqedonas, të cilëve nuk u pëlqen deklarimi i Ziadin Selës pro NATO-s dhe BE-në, por me ndryshime kushtetuese në të cilën shqiptarët do të jenë përfundimisht të barabartë me maqedonasit", janë komentet dhe kundërpërgjigjet e lexuesve shqiptarë në rrjetet sociale, duke komentuar këto kërcënime. Po ashtu bëhet thirrje që organet e rendit menjëherë të ndërmarrin masa për zbulimin e autorëve të këtij grupi që kërcënon me jetë dhe nxit urrejtje. Ndërkohë që më parë, Ziadin Sela, në paraqitjen e tij në opinion pas dhunës barbare të ushtruar ndaj tij në Kuvend, tha se sulmi ndaj tij ishte atentat ndaj kërkesave të shqiptarëve. Sela tha se në 27 prill shqiptarët u vranë, për t'u ringjallur sërish. Ai u shpreh i prerë se para se të kërkojë përgjegjësi politike për ngjarjet e 27 prillit, do të kërkojë përgjegjësi për Sopotin, zbardhjen e Monstrës dhe të vrasjes së Harun Aliut. Ai, gjithashtu, tha se vendimin për pjesëmarrje në qeveri do ta marrin organet e partisë. Megjithatë konfirmoi edhe një herë mbështetjen ndaj qeverisjes së ardhshme. Ndërsa gjatë seancës gjyqësore për personat, të cilët tentuan të vrasin Ziadin Selën në Kuvendin e Maqedonisë, Sela ka kërkuar 500 mijë euro dëmshpërblim për rrahjen në Kuvend, natën e 27 prillit të vitit të kaluar. Avokati i tij ka saktësuar se me këtë shumë përfshihen harxhimet për shërimin fizik, lëndimeve shpirtërore, frikësimin e përjetuar dhe dhimbjet, përfshi shkeljen e identitetit të tij personal.


Ziadin Sela kreu i ASH

**KOMENTUESIT SHQIPTARË:**
"Si duket Ziadin Sela vazhdon të jetë target i huliganëve maqedonas, të cilëve nuk u pëlqen deklarimi i Ziadin Selës pro NATO-s dhe BE-në, por me ndryshime kushtetuese në të cilën shqiptarët do të jenë përfundimisht të barabartë me maqedonasit", janë komentet dhe kundërpërgjigjet e lexuesve shqiptarë në rrjetet sociale.

### PAPA: FËMIJËT ME TENDENCA HOMOSEKSUALE TË TRAJTOHEN

Papa Françesku ka thënë se prindërit duhet të kërkojnë ndihmë te mjekët psikiatër për fëmijët, të cilët tregojnë shenja të homoseksualitetit në moshë të vogël. Sipas 'Daily Mail', Papa 81-vjeçar ka sinjalizuar më parë një qëndrim më tolerant ndaj homoseksualëve krahasuar me disa prej paraardhësve të tij.




### Erdhën për pushime, ekzekutohet një familje në Dibër të Madhe

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur ditën e djeshme në Dibër të Madhe, ndërsa tre anëtarë të një familje shqiptare janë vrarë në oborrin e shtëpisë. Familja banonte në qendër të Dibrës dhe mësohet se viktimat janë Amid Pocesta i lindur në vitin 1963, bashkëshortja e tij Nazmije Pocesta e lindur në vitin 1965 dhe vajza e tyre Anila Poçesta e lindur në vitin 2004. Sipas mediave në Maqedoni autori i vrasjeve është burri i motrës (kunati) me inicialet R.F. për shkak të një konflikti për pronën. Familja shqiptare kishte pak kohë që kishte ardhur nga Italia për pushime në vendin e tyre të lindjes. Forca policie në Maqedoni kanë nisur hetimet për zbardhjen e ngjarjes.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al